



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në:
"Menaxhim në turizëm, mikpritje dhe aktivitete çlodhëse" me profile:
"Turizëm dhe udhëtime", "Mikpritje dhe hoteleri, restorant dhe
katering", "Aktivitete çlodhëse dhe aktivitete në natyrë"
Universiteti "Barleti"**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Dr. Klodiana GORICA

Dr. Nevila ÇINAJ

Maj / 2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Master Profesional në: "Menaxhim në turizëm, mikpritje dhe aktivitete çlodhëse" me profile: "Turizëm dhe udhëtime", "Mikpritje dhe hoteleri, restorant dhe katering", "Aktivitete çlodhëse dhe aktivitete në natyrë"



| | | |
|----|---|--|
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti "Barleti" |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | MP në: "Menaxhim në turizëm, mikpritje dhe aktivitete çlodhëse" me profile", Turizëm dhe udhëtime", "Mikpritje dhe hoteleri, restorant dhe katering", "Aktivitete çlodhëse dhe aktivitete në natyrë" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | Urdhër MASR Nr. 361, datë 17.09.2021 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | - |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | - |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | - |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli i Dytë |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 1 vit akademik, 2 semestra |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 60 kredite (ECTS) |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqipe |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli 7 |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 5 PAE / 3 PAK Bazuar në ngarkesën mësimore rezulton: 76 % PAE /24 % PAK |
| 18 | Numri i studentëve: | 2021-2022: 4 studentë |

| | | |
|----|---------------------|-----------------------|
| | | 2022 2023: 4 studentë |
| 19 | Komente / të tjera: | |

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Barleti" është një institucion jo publik i arsimit të lartë të cilit i është dhënë leja e hapjes dhe ka filluar veprimtarinë e tij akademike mbi bazën e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.571, datë 12.08.2005. Me urdhër Nr. 309, datë 27.07.2012, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencave është bërë riorganizimi i brendshëm i njësive kryesore të SHLUJ "Universiteti Marin Barleti" sipas strukturës së re të kërkuar nga ky institucioni sipas 4 njësive kryesore. Fakulteti i Ekonomisë dhe Financës i përbërë nga 3 njësi bazë; Fakulteti i Drejtësisë me 3 njësi Bazë; Fakulteti i Shkencave Sociale me 3 njësi bazë dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara me 5 njësi bazë. Me VKA Nr. 35, datë 05.05.2015 realizohet riorganizimi i njësive kryesore të Shkollës së Lartë Universitare Jopublike "Universiteti Marin Barleti" në 2 njësi kryesore, përkatësisht Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Politike me 5 njësi bazë dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë me 4 njësi bazë. Me urdhër të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë Nr. 213, datë 03.07.2020 Shkolla e Lartë Universitare Jo Publike "Universiteti Marin Barleti" riorganizohet në Universiteti "Barleti" me tre njësi kryesore; Fakulteti i Ekonomisë Qeverisjes dhe Drejtësisë me 3 njësi bazë; Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative me 3 njësi bazë dhe Fakulteti i Shkencave Sociale Turizmit dhe Sportit me 4 njësi bazë. Me UMAS Nr. 117, date 09.03.2022 hapet njesia e re kryesore Fakulteti i Shkencave Mjekesore, pas kesaj UNIBA ka bere ndryshime ne statut dhe organigrame me Vendim Senati Nr. 24, date 17.10.2022 dhe Vendim Bordi Nr. 9, date 18.10.2022. Keto ndryshime ne statut jane miratuar me UMAS Nr. 78, date 9.2.2023.

Njësia bazë që ofron programin e studimit Master Profesional në: "Menaxhim në turizëm, mikpritje dhe aktivitete çlodhëse" me profile: "Turizëm dhe udhëtime", "Mikpritje dhe hoteleri, restorant dhe katering", "Aktivitete çlodhëse dhe aktivitete në natyrë", është Departamenti i Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit. Programi është hapur me Urdhër MASR Nr. 361, datë 17.09.2021. Ky program studimi realizohet me 60 kredite (ECTS), në formën e studimeve me kohë të plotë, me kohezgjatje normale 1 vit akademik, të ndarë në 2 semsetra, në gjuhën shqipe, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë Master Profesional në: "Menaxhim në turizëm, mikpritje dhe aktivitete çlodhëse" me profile: "Turizëm dhe udhëtime", "Mikpritje dhe hoteleri, restorant dhe katering", "Aktivitete çlodhëse dhe aktivitete në natyrë".

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Qëllimi i këtij vlerësimi për programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional në: "Menaxhim në turizëm, mikpritje dhe aktivitete çlodhëse" me profile: "Turizëm dhe udhëtime", "Mikpritje dhe hoteleri, restorant dhe katering", "Aktivitete çlodhëse dhe aktivitete në natyrë", është vlersimi i shkallës së përmbushjes së Standardeve Shtetërore të Cilësisë, të cilat janë në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë", i ndryshuar.

Vlerësimi i programit të studimit është një proces vlerësimi nga ekspertë të jashtëm i përcaktuar me urdhër të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë " Për përcaktimin e Ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programeve të studimit të ciklit të dytë, aplikuar nga Universiteti "Barleti". Grupi i vlerësimit të jashtëm i përbërë nga Prof. Dr. Klodiana Gorica dhe Dr. Nevila Çinaj, Msc.Majlinda Demirneli (koordinatore teknike) nisi punën për realizimin e procesit të vlersimit të jashtëm në kuadër të akreditimit të programit të studimit.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkuara nga Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 "Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë", VKM Nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë", në Udhëzimin Nr. 31 datë 29.12.2017 "Për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë".

Gjatë vizitës së kryer në institucion, në datat 7 dhe 8 Shkurt 2023, u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të Universitetit Barleti, Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit, Departamentit të Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit. Këto takime u shoqëruan me diskutime intensive dhe në përfundim të tyre GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi.

Universiteti "Barleti" është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 10.05.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 13/52 Prot, datë 10.05.2023. Universiteti "Barleti" përcjell në ASCAL më datë 19.05.2023, me anë të shkresës me Nr. 603 Prot, datë 17.05.2023, "Kthim përgjijge tuajës Nr. 13/52 Prot, datë 10.05.2023", ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në: "Menaxhim në turizëm, mikpritje dhe aktivitete çlodhëse" me profile: "Turizëm dhe udhëtime", "Mikpritje dhe hoteleri, restorant dhe katering", "Aktivitete çlodhëse dhe aktivitete në natyrë",

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

| Standardi I.1 | |
|--|---|
| Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p> | <p>Në dokumentat strategjike të institucionit, ku bën pjesë programi i studimit, theksohet rëndësia e këtij institucioni në raport me qasjen ndaj inovacionit dhe sipërmarrjes, duke e kthyer atë në një universitet aplikativ, me një qasje shumë më të madhe drejt tregut dhe nevojave të tij dhe rrjedhimisht në mbështetje të interesave kombëtare. Ky program studimi ndërtohet dhe në mbështetje të Strategjisë Kombëtare për zhvillimin e turizmit si dhe në mbështetje të Ligjit të Arsimit të Lartë Shqiptar. Së pari synon të rrisë në nivele kombëtare profesionalizmin dhe standartizojë shërbimet në turizmin shqiptar dhe së dyti synon të forcojë vlerat akademike kombëtare.</p> <p><i>Dok.1.3. Strategjia e zhvillimit institucional 2020-2030</i></p> <p><i>Dok.1.2. Statuti I Universitetit Barleti</i></p> <p><i>Dok.3 Strategjia Kombëtare e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit 2019-2023, qëllimi strategjik, fq.3</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p> | <p>Strategjia e zhvillimit institucional 2020-2030 konfirmon dhe thekson të rëndësishëm në politikat e tij, formimin multidisiplinor dhe aftësitë soft. Aty theksohet se UniBa do të jetë një universitet aplikativ, inovator dhe krijues. Misioni dhe vizioni i shprehur në këtë strategji tregojnë qartë qasjen me zhvillimin e vendit dhe të sektorëve më të rëndësishëm të tij si dhe qasjen e një universiteti aplikativ të fokusuar fort sa në shkencë aq dhe në inovacion dhe sipërmarrje.</p> <p><i>Dok. 1.3 – Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet</p> | <p>Strategjia e zhvillimit institucional 2020-2030 konfirmon dhe thekson të rëndësishëm në politikat e tij sfidat e profesionistëve të</p> |



| | | | | |
|--|--|-------------------------------------|------------------------------------|---|
| <p>në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p> | <p>së ardhmes (fq.10), ku theks i vecantë vihet në ndërveprimin me industrinë në kuadër të universitetit aplikativ (fq.12). Gjithashtu në Statutin e Universitetit dhe Rregulloren e Institucionit, miratuar me vendim të Senatit Akademik nr.60, datë 13/04/2021, përcaktojnë në objektivat, parimet dhe shtyllat e aktiviteteve kryesore të UniBa, drejtimet prioritare akademike dhe demostrojnë qartë se programet e studimit hartohen në zbatim të tyre, në funksion të pasjes së një universiteti novativ dhe sipërmarrës. Ky program studimi ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit, Departamenti i Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit. Emërtimi, struktura dhe organizimi i programit të studimit bazohet dhe është ndërtuar mbi fushat e drejtimit akademik dhe të kërkim zhvillimit të UniBa.</p> <p><i>Dok. 1.1 - Rregullore e Universitetit Barleti</i></p> <p><i>Dok. 1.2 – Statuti UniBa, Tirana 2020</i></p> <p><i>Dok. 1.3 – Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030, fq. 4.</i></p> | | | |
| <p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p> | <p>Në dokumentacionin e paraqitur për studimin e tregut para licensimit të programit si dhe në RVB-në e paraqitur nga institucioni, theksohet që për hartimin e programit të studimit është bazuar në nevojat e tregut për specialistë dhe ekspertë të industrisë së turizmit si dhe në përputhje me kërkesat dhe prioritetet me interes kombëtar, të paraqitura dhe në Strategjinë Kombëtarepër Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023 (fq.3 dhe fq.22).</p> <p><i>Dok. 35 - VKM 413/2019 - Strategjia kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit 2019–2023 , Qëllimi Strategjik</i></p> | | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>Bazuar në sa më lart, UniBa, i cili ofron programin e studimit, përmbush plotësisht kriteret e vlerësimit dhe synon ruajtjen e interesave kombëtare, akteve ligjore dhe nënligjore, etj. Në dokumentat ligjor institucional, janë të shprehura qartë misioni dhe vizioni i institucionit për programe studimi aplikative dhe inovatore.</i></p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |

Standardi I.2






Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p> | <p>Institucioni Marin Barleti tashme ka forcuar kapacitetet e veta infrastrukturore dhe njerëzore për ofrimin e programeve cilësore. Koherenca në treg, përpjekjet cilësore për përmirësimet e vazhdueshme të programeve ekzistuese dhe lançimin e programeve të reja inovative, qasjet inovative për tërheqjen e sa me shumë studentëve, përpjekjet për të gjeneruar dhe përmirësuar ndjeshëm cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies, përfshirja intensive e studenteve sikurse përpjekjet cilësore për të rritur jetën sociale brenda universitetit, lidhja me tregun, marrëveshjet efiçente me bizneset dhe institucionet e tjera janë disa nga treguesit e përgjithshëm të identifikuar dhe certifikuar ndjeshëm në këtë dekadë.</p> <p>Referuar Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit për vitin akademik 2021-2022, ka gjithsej 87 pedagogë, nga të cilët 42 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: 4 kanë titullin “Profesorë”, 4 kanë titullin “Profesor i Asociuar”, 12 kanë gradën Dr./PhD, dhe 22 Asistent Lektorë me Msc; dhe 45 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 5 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 17 kanë gradën Dr./PhD. dhe 23 Asistent Lektorë me Msc.</p> <p>Ndërsa në departament për vitin akademik 2021-2022, janë 7 lektorë, si personel akademik efektiv (PAE), nga të cilët janë 1 me titullin “Profesor i Asociuar”, 3 “Doktorë” dhe 3 Msc, dhe 4 personel akademik me kontratë (PAK), nga të cilët janë 1 me titullin “Profesor i Asociuar”, 2 “Doktorë” dhe 1 Msc.</p> <p><i>Dok. 30 - Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB, tabela 1 dhe 2</i></p> <p><i>Dok 30 - Tabelat përmbledhëse për Anek tab 1 dhe 2</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të</p> | <p>Nga takimet me dekanin dhe drejtuesin e departamentit u gjykua se fakulteti si njësi e rëndësishme dhe përmbledhëse e disa programeve përkatëse është munduar të ndërthurë programet përkatëse, ku turizmi është në fokusin e universitetit por edhe me ambiciet e administratorëve dhe drejtuesve përkatës për t’u cuar më përpara, së pari sepse ka të ardhme, se dyti se universitetet shqiptare duhet të fokusohen në këto drejtime të rëndësishme, por edhe pse nuk janë numrat e duhur të studentëve, është mirë që këto programe të kompletohen dhe përmirësohen vazhdimisht.</p> |



| | |
|---|--|
| <p>programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> | <p>Në këtë konteks ky department është në fokusin e universitetit. Ka interes për më shumë numra, por më e rëndësishme është që departamenti të forcohet në këto programe që ofron duke u bërë konkurrent, që me tej sipas nevojave që ka tregu për specialist edhe ky program të rritet cilësisht dhe nga ana sasiore.</p> <p>I gjithë ky diskutim u mbështet edhe nga takimet me studentet dhe drejtuesit e njësisve të tjera të cilët shprehën mbështetjen që institucioni dhe njësia kryesore i jep këtij program studimi.</p> |
| <p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p> | <p>Ky program studimi ofrohet nga DTMR, pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit. Kalimi i ofrimit të këtij programi nga Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve e rrit rëndësinë e tij për shkak se dhe departamenti dhe fakulteti kane lidhje direkte me turizmin dhe i dedikohen atij si dhe përbën një këndvështrim më të gjerë dhe në kontekstin social dhe aktiviteteve rekreative sportive. Ky program studimi është hartuar sipas Legjislacionit në fuqi dhe Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe i regjistruar si program i ciklit të dytë të studimit, Master Profesional, niveli i shtatë i kornizës Kombëtare të kualifikimeve dhe përfshirë në fushën kryesore "Shkenca Sociale", ku fushat e studimit janë: turizmi, udhëtimet, mikpritja dhe aktiviteteve çlodhëse dhe aktivitete në natyrë. Në përfundim të këtij program studimi lëshohet Diplomë për ciklin e dytë të studimeve Master Profesional në: "Menaxhim në turizëm, mikpritje dhe aktivitete çlodhëse" me profile: "Turizëm dhe udhëtime", "Mikpritje dhe hoteleri, restorant dhe catering", Aktivitete çlodhëse dhe aktivitete në natyrë".</p> <p><i>Evidenca 1 - Rregullore departamenti</i></p> <p><i>Evidenca 3 - Rregullore e programit të studimit</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p> | <p>Nuk është e aplikuar në këtë IAL</p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në</p> | <p>Institucioni ofron kurse dhe trajnime të formimit profesional të vazhduar, të cilat u ofrojnë mundsi studentëve të trajnohen dhe kualifikohen në tregun e punës. Konkretisht UniBa është e licensuar për ofrimin e kursit të kualifikimit profesional:</p> |

| bashkërendim me punëdhënësit. | <p>Udhërrëfyes Turistik Kombëtar, Udhërrëfyes Turistik i Specialitetit të Vecantë dhe Udhërrëfyes Turistik Lokal. Gjatë takimeve të GVJ me përgjegjës të departamentit dolën në pah dhe kurset e tjera të trajnimit, ku strukturat e institucionit janë të licensuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për kurset që lidhen me hotelerinë, restorantet, etj. Gjithashtu Zyra Alumni dhe Karriera zhvillon në mënyrë periodike trajnime me studentët për tema që lidhen drejtpërdrejtë me fushën e tyre të studimit.</p> <p><i>Dok. 36 - Shkresë nga MASR për akreditimin e programit Udhërrëfyes Turistik Kombëtar, dt. 28.12.2018.</i></p> <p><i>Dok. 36.1 – Vendim i dekanit për organizimin e programit të Udhërrëfyesit Turistik</i></p> <p><i>Doc. 37 - Aktivitete të zyrës Alumni dhe Karriera për vitin akademik 2021-2022</i></p> | | | | | | | | | | | |
|--|--|-----------------------|--|--|-----------------------|--|---|----------------------|--|---|-----------------------|---|
| Konkluzione | <p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</i></p> | | | | | | | | | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | <table border="1"> <tr> <th data-bbox="544 1012 740 1111">Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td data-bbox="544 1117 740 1167"></td> </tr> </table> | Përmbushet plotësisht | | <table border="1"> <tr> <th data-bbox="745 1012 941 1111">Përmbushet pjesërisht</th> </tr> <tr> <td data-bbox="745 1117 941 1167"></td> </tr> </table> | Përmbushet pjesërisht | | <table border="1"> <tr> <th data-bbox="946 1012 1158 1111">Përmbushet kryesisht</th> </tr> <tr> <td data-bbox="946 1117 1158 1167"></td> </tr> </table> | Përmbushet kryesisht | | <table border="1"> <tr> <th data-bbox="1163 1012 1406 1111">Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td data-bbox="1163 1117 1406 1167" style="text-align: center;">X</td> </tr> </table> | Përmbushet plotësisht | X |
| Përmbushet plotësisht | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | |
| Përmbushet pjesërisht | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | |
| Përmbushet kryesisht | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | |
| Përmbushet plotësisht | | | | | | | | | | | | |
| X | | | | | | | | | | | | |

| Standardi I.3 | |
|--|--|
| <p>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p> | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së</p> | <p>Ky program studimi është hapur për herë të parë në vitin akademik 2021-2022, me synim për të thelluar më tej kualifikimin e studentëve dhe për të pasur një qasje profesionale ndaj tregut. Ashtu sikurëve u konstatua edhe nga vizita në terren, brenda institucionit ka patur një mështetje pozitive për të hapur këtë program studimi dhe për t'a bërë atë të sukseshëm. Për këtë janë angahuar jo vetëm departamenti i DTMR si përgjegjës për këtë program studimi, por edhe njësitë e tjera si ajo përgjegjëse për cilësinë, karrierën apo etikën. DTMR ka hartuar rregulloren</p> |

| | |
|---|--|
| <p>përgjegjësi përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p> | <p>dhe mban në mënyrë periodike mbledhjet për mbarëvajtjen e këtij program studimi. Përveç përgjegjësit të departamentit janë ngritur dhe shumë njësi të tjera si kordinatori i programit, bordi i karrierës, dekani i studentëve, zyra alumni dhe karrierës.</p> <p><i>Plani strategjik i zhvillimit të programit</i></p> <p><i>Rregullore e programit studimit</i></p> <p><i>Evidenca 1 - Rregullore Fakulteti</i></p> <p><i>Evidenca 1 - Rregullore departamenti</i></p> <p><i>Evidenca 1.1 Rregullore e Universitetit Barleti</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p> <p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p> | <p>Bazuar jo vetem ne dokumentacionet perkatese qe njesia baze ofron per vleresim, por vecanerisht edhe nga diskutimet me drejtuesin e njesise baze gjykohet se:</p> <p>Departamenti si njesia baze qe ofron kete program studimi synon, perpiqet dhe lufton per permiresime cilesore te programit, per te patur nje vijemesi te natyrshme dhe te ofruar si nje pakete te plote bachelorin dhe masterin brenda departamentit. Kjo perben nje nder menytrat me atraktive qe tregje te ndryshme te synuara te studenteve te terhiqen, duke filluar qe nga studentet qe kane mbaruar bachelorin po prane ketij departamenti per turizem, po ashtu edhe student te universiteteve te tjera publike dhe private qe kane mbaruar studimet gjetke dhe mund te vijojne te ndjekin masterin prane ketij departamenti.</p> <p>Gjithashtu ajo cka eshte e rendesishme eshte edhe gjykimi cilesor qe drejtuesi i njesise baze por edhe stafi perkates mbeshtesin llogjikën se ky program studimi sherben si ure nderlidhese mes biznesit dhe studenteve. Kete e ben duke mundesuar perpjekjete per punesimet e studenteve per t'i ofruar ato sa me shume me tregun. Keshtu, te gjithë studentet jane te punesuar ne tregun e turizmit, te gjithë mbajne lidhje te forta dhe cilesore me fakultetin. Vecanerisht Dekani i Stuenteve perben nje pike kyce te rendesishme per studentet, jo vetem per aktivitetet kulturore dhe sociale brenda universitetit por edhe per problematika te rendesishme ose edhe fare te thjeshta. Ne kete menyre studentet mbeshteten fort dhe cilesisht qe nga stafi i brendshem dhe i jashtem, drejtuesi i departamentit dhe dkcani i studnteve, per te mos thene se mjedisi rekreativ dhe plot aktivitete qe “pushton” mjediset e universitetit vertet perben nje klime mjaft atraktive per kedo qe synon te beje studimet e veta ne nje IAL me standarte</p> |



| | | | | |
|---|--|-----------------------------|------------------------------|--|
| | cilesore. | | | |
| Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | <p>Nga dokumentacioni i paraqitur nga ana e institucionit si dhe takimet me përgjegjësën e njësisë bazë, stafin si dhe studentët rezulton se njësia bazë ka një sërë marrëveshjesh të nënshkruara. Marrëveshjet e bashkëpunimit dhe efektiviteti i tyre bëhen të dukshme gjatë procesit të realizimit të praktikave, por dhe mundësisë së punësimit të studentëve pas përfundimit të studimeve. Institucionet e bashkëpunimit luajnë një rol kyc në përfitimin e njohurive praktike por dhe lidhjes direkte të studentëve me tregun e punës.</p> <p>Nga takimi me përgjegjësën e njësisë bazë u analizua rëndësia e tyre, por dhe ristrukturimi që ato po bëjnë brenda departamentit në funksion të fuqizimit të kapaciteteve me aktorët që operojnë në industrinë e turizmit si ato privat dhe publike. Nga raportet analitike të bëra nga njësia bazë, ka dale e nevojshme rritja e bashkëpunimit dhe fuqizimit të departamentit me industrinë, në funksion të përmirësimit të aftësive praktike të studentëve si dhe punësimit potencial të tyre.</p> <p><i>GVJ rekomandon që të shtohet numri i marrëveshjeve me industrinë si dhe ato shtetërore.</i></p> <p><i>Evidenca 38. Vendim per krijimin e bordit te karrieres</i> <i>Evidenca 39 Analiza vjetore e departamentit 2021-2022</i></p> | | | |
| Konkluzione | <p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se institucioni siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit. Njësia bazë ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunuese dhe është në zgjerim të vazhdueshëm të bashkëpunimit me industrinë dhe organizatat që merren me fushën e turizmit.</p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | |
| | | | X | |

| | | | | |
|---|---------------|----------------------|---------------------|----------------------|
| Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës I | Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht |
| | | | | X |



II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

| Standardi II.1 | |
|---|---|
| Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> | <p>Pas shqyrtimit të planit mësimor të programit të studimit të paraqitur nga institucioni, takimeve të realizuara gjatë vizitës në UniBa, konkludojmë se programi është i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me udhëzimet e MAS, me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve. Lëndët e këtij programi janë kategorizuar në kategoritë A-E, dhe kreditet janë në përputhje me përqindjen e parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Në përfundim të studimeve të tyre studentët e këtij programi grumbullojnë 60 ECTS.</p> <p><i>Dok. 2 - Dosja e programit të studimit</i> <i>Dok. 27 - Akte ligjore e nënligjore</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme</p> | <p>Plani mësimor i programit të studimit Master Profesional MTMAÇ, është hartuar në përputhje me dispozitat nënligjore në fuqi. Ky program studimi përbën një përpjekje për të furnizuar studentët me dije, njohuri dhe ekspertizë të konsiderueshme profesionale e aplikative, për një punësim të sigurt dhe punë të kualifikuar.</p> <p><i>Evidenca 2 - Dosja e programit të studimit</i> <i>Evidenca 3 - Rregullore e programit të studimit</i></p> |

| | |
|---|--|
| <p>për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p> | |
| <p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p> | <p>Programi i studimit ka të parashikuar ngarkesën në kredite të praktikës profesionale (7 kredite) në ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.</p> <p><i>Evidenca 2 - Dosja e programit të studimit</i> <i>Evidenca 2.3 - Paketa e Praktikës</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p> | <p>Nuk aplikohet në rastin e këtij program studimi</p> |
| <p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p> | <p>Nuk aplikohet në rastin e këtij program studimi</p> |

| | | | | |
|---|--|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p> | <p>Nga evidencat e paraqitura si dhe vizita ne IAL konkludojmë se për studentët me status të vecantë procedohet konform zbatimit të kuadrit ligjor të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për këto kategori, gjë e cila është e reflektuar dhe në rregulloren e IAL dhe njësive kryesore dhe bazë.</p> | | | |
| <p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet</p> | <p>Nuk aplikohet në rastin e këtij program studimi</p> | | | |
| <p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p> | <p>Nuk disponohen ne programin mesimor te paraqitur</p> | | | |
| <p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> | <p>Nuk aplikohet në rastin e këtij program studimi</p> | | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se programi i studimit eshte i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore. Permbushet plotesisht.</i></p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|-----|-----|-----------|---|---|---------------|---|---|------------|----|----|------|----|----|-----------------|-----------|-----------|---------------|-----------|--|
| <p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p> | <p>Programi i studimit ofrohet nga njësia bazë, Departamenti i Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit (DTMR), që funksionon brenda njësisë kryesore. “Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve” është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 571, dt. 12.08.2005, riorganizuar me Urdhër të Ministrit të MASR nr. 511, dt. 24.10.2019 dhe po me Urdhër të Ministrit të MASR nr. 213, dt. 03.07.2020.</p> <p>Institucioni ka zhvilluar procesin e akreditimit Institucional në kuadër të akreditimit periodik, me Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 60, datë 16.12.2021 është akredituar për 5 vite deri më 15.12.2026.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit për vitin akademik 2021-2022, ka 87 staf akademik gjithsej, ku 42 janë pedagogë me kohë të plotë, dhe 47 pedagogë me kohë të pjesshme.</p> <table border="1" data-bbox="568 1218 1378 1675"> <thead> <tr> <th data-bbox="568 1218 1062 1317">Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit</th> <th data-bbox="1067 1218 1222 1317">PAE</th> <th data-bbox="1227 1218 1378 1317">PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="568 1317 1062 1377">Prof. Dr.</td> <td data-bbox="1067 1317 1222 1377">4</td> <td data-bbox="1227 1317 1378 1377">-</td> </tr> <tr> <td data-bbox="568 1377 1062 1438">Prof. As. Dr.</td> <td data-bbox="1067 1377 1222 1438">4</td> <td data-bbox="1227 1377 1378 1438">5</td> </tr> <tr> <td data-bbox="568 1438 1062 1498">Dr. / PhD.</td> <td data-bbox="1067 1438 1222 1498">12</td> <td data-bbox="1227 1438 1378 1498">17</td> </tr> <tr> <td data-bbox="568 1498 1062 1559">MSc.</td> <td data-bbox="1067 1498 1222 1559">22</td> <td data-bbox="1227 1498 1378 1559">23</td> </tr> <tr> <td data-bbox="568 1559 1062 1619">Në total</td> <td data-bbox="1067 1559 1222 1619">42</td> <td data-bbox="1227 1559 1378 1619">45</td> </tr> <tr> <td data-bbox="568 1619 1062 1675">Totali</td> <td colspan="2" data-bbox="1067 1619 1378 1675">87</td> </tr> </tbody> </table> <p>Konstatojme se Departamenti i Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit, në vitin akademik 2021-2022, ka 11 personel akademik gjithsej, 7 pedagogë me kohë të plotë dhe 4 pedagogë me kohë të pjesshme</p> | Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit | PAE | PAK | Prof. Dr. | 4 | - | Prof. As. Dr. | 4 | 5 | Dr. / PhD. | 12 | 17 | MSc. | 22 | 23 | Në total | 42 | 45 | Totali | 87 | |
| Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit | PAE | PAK | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Prof. Dr. | 4 | - | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Prof. As. Dr. | 4 | 5 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Dr. / PhD. | 12 | 17 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| MSc. | 22 | 23 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Në total | 42 | 45 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Totali | 87 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |

| | | | | |
|---|--|-------------------------------------|------------------------------------|---|
| <p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p> | <p>Nga konsultimi me dokumentacionin e vënë në dispozicion, por edhe nga konstatimet përgjatë vizitës në institucion, konstatohet se studenti krahas seancave në auditor kryen praktikë në një institucion/organizatë/kompani i mbikqyrur nga një pedagog i caktuar nga Departamenti. Në rastin e këtij programi studimi, rolin e pedagogut mbikqyrës për praktikën mësimore e ka kryer koordinatori i departamentit. Të gjitha procedurat janë të përcaktuara në paketën e praktikës.</p> <p><i>Dok. 2.3 - Paketa e Praktikës</i></p> | | | |
| <p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p> | <p>Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, bazuar në Urdhrin e Rektorit nr.34, (<i>Evidenca 3.1</i>), cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e përcaktuara në Rregulloren e Departamentit si dhe dokumentacionin e zhvillimit të praktikave.</p> <p><i>Evidenca 1 - Rregullore departamenti, neni 6</i></p> <p><i>Evidenca 3.1- Vendim për emërimin e koordinorit të departamentit</i></p> | | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi. Përmbushet plotësisht.</i></p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |

| | |
|--|--|
| <p>Standardi II.3</p> | |
| <p>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon</p> | <p>Grupi i ekspertëve të jashtëm, pas shqyrtimit të Dosjes së Vetëvlerësimit të programit të studimit, takimeve gjatë vizitës në UniBa dhe dokumentave shtesë pas vizitës në Institucion, thekson se DTMR disponon informacionin e nevojshëm lidhur me</p> |

informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.

organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, të cilat ju vihen në dispozicion studentëve që ndjekin këtë program studimi. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, programi i studimit është organizuar sipas Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programit të studimit të ofruar nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar dhe rregullores së programit të studimit. GVJ konstatoi se programi i studimit është i organizuar në lëndë, aktivitete formuese dhe praktikë profesionale të vlerësuara me kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS), të cilat zhvillohen në një vit akademik, të ndarë në dy semestra.

Dok. 2 – Dosja e programit të studimit

Dok. 2.3 – Paketa e praktikës

Dok. 3 - Rregullorja e programit të studimit

Dok. 23 - Udhëzues për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit + Aneks

Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.

Programi është i ndërtuar konform formateve të lejuara nga ligji dhe përfshijnë një informacion të hollësishëm mbi ngarkesën e punës mësimore në auditor apo jashtë tij, frekuentimin e lëndës si dhe metodat e vlerësimit të njohurive, apo penalizimet në mos përmbushje për arsye të ndryshme. Plan-programi i studimit është hartuar bazuar në legjislacionin në fuqi, i ndarë në kredite dhe disiplina karakterizuese përkatëse. Kreditet janë të ndara në leksione, seminare, ushtrime, laboratore, praktikë, si edhe punë e pavarur e studentëve. Programi i studimit Master Profesional në “MTMAÇ”, me profile: 1. Turizëm dhe Udhëtime; 2. Mikpritje dhe hoteleri, restorant dhe katering 3. Aktivitete çlodhese dhe aktivitete ne natyre, ka në total 60 ECTS, për 1 vit akademik, 30 ECTS çdo semester. Ndarja e kategorive të veprimtarive formuese është në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, të ndryshuar.

| Kategoria | % e lejuar sipas VKM | % ne planin mësimor |
|-----------|-----------------------|---------------------|
| A | (5-10 % e krediteve) | 8.4% |
| B | (30-40 % e krediteve) | 40% |

| | | |
|-------|----------------------|-------|
| C | (20-30% e krediteve) | 25% |
| D | (10% e krediteve) | 10% |
| F | (10-20% e krediteve) | 16.6% |
| Total | 100% | 100% |

Dok. 2 – Dosja e programit të studimit

Dok. 2.3 – Paketa e praktikës

Dok.1.1 - Rregullore e Universitetit Barleti

Dok. 3- Rregullorja e programit të studimit

| | |
|--|---|
| <p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> | <p>Zyrat për studentët dhe zhvillim të karrierës u ofrojnë studentëve të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve të cilat specifikohen mjaft qartë në “Manual Rekrutim-Aplikim-Regjistrim-Transferim”.</p> <p><i>Dok. 1.1 - Rregullore e Universitetit Barleti</i></p> <p><i>Dok. 3 - Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Dok. 18-19 - Manuali i rekrutimit të studentëve</i></p> <p><i>Dok. 19.1 - Rregullore për transferimin e studentëve</i></p> |
|--|---|

| | |
|--|---|
| <p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p> | <p>Programet lëndore të programit të studimit Master Profesional në “MTMAÇ”, me profile, janë të organizuara në përputhje me formatet e miratuara, <u>por per një pjesë të silabuseve të programit sugjerojmë përditësimin dhe përmirësimin e tyre.</u></p> <p><i>Dok. 1.1 - Rregullore e Universitetit Barleti</i></p> <p><i>Dok. 2 – Dosja e programit të studimit</i></p> <p><i>Dok. 3- Rregullorja e programit të studimit</i></p> <p><i>Dok. 27 - Aktet ligjore e nënligjore</i></p> |
|--|---|

| | |
|---|--|
| <p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe</p> | <p>Nga takimet e realizuara në institucion konfirmojmë angazhimin e departamentit për rishikimin dhe përditësimin e programeve të studimit dhe planit mësimor bazuar në nevojat dhe treguesit akademik. Kjo procedurë duhet të ndiqet me rigorozitet duke zbatuar me përpikmëri masën e lejuar mbi ndryshimet përkatëse në planin mësimor si dhe në zbatim të akteve nënligjore në fuqi.</p> <p><i>Dok. 1.1 - Rregullore e Universitetit Barleti</i></p> |
|---|--|

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht. | <i>Dok. 3 - Rregullore e programit të studimit</i> <i>Dock. 16 - Manuali i programeve të studimit</i> | | | |
| Konkluzione | <i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë. <u>GVJ rekomandon rishikimin e temave te sylabuseve te lendeve te profilit si dhe pasurimin e literatures.</u></i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Niveli i përmbushjes | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| Standardi II.4 | |
|--|--|
| Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p> <p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p> <p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti</p> | <p>Në lidhje me planin mësimor gjykojmë që ndërhyrjet e mëposhtme janë të domosdoshme. Këto ndërhyrje u diskutuan me drejtuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë, u analizuan edhe me stafin e këtij programi studimi dhe u bënë me dije dhe në takimin final me drejtuesin e njësisë bazë.</p> <p>Tipologjia e komenteve dhe sugjerimeve drejtuar planit mesimor i perket 3 kategorive:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Riklasifikim i moduleve sipas tipit te veprimtarise; • Përfshirje të lëndëve bazë dhe ato të kategorive të tjera që lidhen direkt me formimin e studentëve për qellimin qe ka dhe synon ky program studimi, kryesisht përfshirjen e lëndëve që janë të lidhur me turizmit, mikpritjen dhe aktivitetet clodhese; • Zëvendësim i lendeve ekzistuese me lende te tjera qe perfshijne ato ekzistuese; <p><u>Ne kategorine e pare, konkretisht ne lidhje me riklasifikimin e moduleve sipas tipit te veprimtarise sugjerimet jane si me poshte vijon:</u></p> <p>Moduli “Metoda te kerkimit shkencor” nuk sugjerohet te</p> |



| | |
|--|--|
| <p>teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p> | <p>perfshihet ne kete plan mesimor, me argumentimin se masteri profesional nuk ka nevojë te perfshije lende te kerkimit shkencor. Nese do te ishte master shkencor pa diskutim qe do ishte e nevojshme.</p> <p><u>Ne kategorine e dyte sugjerohen ndryshimet e meposhtme:</u></p> <p>Perfshirja e lendes: “Marketing Digital” dhe zevendesimi i saj me “Manaxhimin Strategjik te Burimeve Njerezore”. Kjo per arsye se ne ditet e sotme, lenda e digitalizimit ka marre rendesi ne te gjitha operacionet dhe zinxhirin e vleres ne turizem dhe aplikueshmeria ne industrine e sherbimeve turistike ka nje qasje me te vecante dhe jetike per kete industrinë. Aktualisht lenda “Marketing” zhvillohet ne semestrin e dyte per te tre profilet.</p> <p>Pra thjesht te kaloje ne sem e pare.</p> <p>Zevendesimi i modulit “Komunikimi integruar Marketing” me moduln “Marketingu Turizmit”. KMI eshte nje nder 4 elementet e marketingut te turizmit se pari, dhe se dyti marketing i turizmit perben nder shtyllat baze te nje masteri te tille si shkencor ashtu edhe profesional.</p> <p>Tek lendet e sem 2 rekomandohet sipas profileve:</p> <p>“Marketing digital” qe kalon ne sem e pare si lende baze te zevendesohet me “manaxh eventesh” ne profilin Mikpritje dhe HORECA</p> <p>Ne profilin turizem dhe udhetime moduli “marketing digital” te zevendesohet me “Transport dhe turizmi”.</p> <p>Ne profilin e trete lenda “marketing digital” te zevend me “turizmi i bazuar ne natyre”.</p> <p><u>Sugjerohen qe ndryshimet e vitit te pare jane mjaft te rendesishme dhe paresore ne ndryshim.</u></p> |
| <p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p> | <p>Në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet ne institucion konstatojmë që veprimtaritë formuese përmes trajtimeve teorike, praktike, seminareve apo aktiviteteve të tjera, lehtësojnë arritjen e objektivave mësimore, transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin në fund të programit të studimit, në përputhje me standartet akademike dhe strategjitë e zhvillimit të UniBa.</p> <p><i>Dok. 2 – Dosja e programit te studimit</i></p> <p><i>Dok. 27 - Aktet ligjore e nënligjore</i></p> |

| | |
|--|--|
| | <p><i>Dok. 10 - Strategjia e nderkombetarizimit</i></p> <p><i>Dok. 10.2 - Marreveshje institucionale</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p> | <p>Konstatohet se syllabuset e të gjitha lëndëve në këtë program studimi janë në përputhje me vendimet ligjore duke filluar me pasqyrën informative të lëndës, rezultatet e të nxënit, konceptet themelore, temat e detajuara të lëndës, format e kontrollit të dijeve, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm, literatura dhe në fund vërejtje përfundimtare nga pedagogu. Në parim, funksionon që në fillim të çdo viti akademik pedagogëve u kërkohet përditësimi i sylabuseve. Ata i përditësojnë duke iu referuar literaturës së detyruar apo ndihmëse vendase dhe të huaj të azhurnuar në 5 vitet e fundit me profilin specifik lëndor, por praktikisht ka dhe problematika të cilat lidhen me përplasje të tematikave apo sigurimit të literaturës.</p> <p><i>Dok.2 – Dosja e programit te studimit</i></p> <p><i>Dok. 3 – Rregullorja e programit te studimit</i></p> <p><i>Dok. 39 - Analiza vjetore e departamentit 2021-2022</i></p> <p><i>Dok. 40 – Të dhëna për bibliotekën e programit</i></p> |
| <p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p> | <p>Programi është në përputhje me profilin e IAL dhe strategjinë e tij për zhvillim. Një nga objektivat e këtij programi studimi është formimi i studentëve, në dijet, aftësitë dhe kompetencat deri në punësimin e tyre. Kjo është arsyeja pse Departamenti interesohet deri në procesin e punësimit të studentëve. Duke hetuar se cila nga pjesa e programit mund të kishte funksionuar më mirë dhe si mund të përmirësohet.</p> <p><i>Dok 3 - Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Dok. 4 - Misioni dhe studimi i tregut</i></p> <p><i>Dok. 2 – Dosja e programit te studimit</i></p> |
| <p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p> | <p>GVJ konstaton se ka një program mentorimi të strukturuar mbi të cilën të udhëhiqen studentët në karrierën e tyre, sic kemi konstatuar më sipër. IAL disponon lista të rregullta të çdo studenti deri në procesin e punësimit të tyre, Programi u mundëson studentëve vijimin e karrierës së tyre profesionale dhe punësimin në industrinë e turizmit.</p> <p><i>Dok. 2 – Dosja e programit te studimit</i></p> <p><i>Dok. 3 - Rregullore e programit të studimit</i></p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Konkluzione | <i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. <u>GVJ rekomandon rishikimin e planit mesimor dhe perfshirjen e disa lendeve dhe moduleve, te cilat jane listuar me lart.</u></i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Jo përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X | |

| Standardi II.5 | |
|---|--|
| Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. | <p>Pergjate vizites ne institucion, nga drejtuesi i njesise kryesore gjykohet se: “Programet tona jane te mire konsultuara edhe me jashte vendit, jemi ne rrugen e duhur per te ofruar nevojat shume komplekse qe ka ky sektor. Sigurisht qe nevojat e tregut nuk plotesohen me ate cka ofron ky program por permiresimet cilesore te ketij program do te afrohemi me shume drejt kesaj.”</p> <p>Po nga drejtuesi i njesise baze, gjykohet mbeshtetja e vazhdueshme dhe perpjekjet per te rritur cilesine e ketij procesi. Keshtu drejtuesi i departamentit gjykon dhe thekson se pikat e forta te ketij programi lidhen edhe me kompletimin e bachelorit dhe masterit si nje formim i plote brenda nje universiteti, pra te ofruar si nje pakete cilesore si dhe punesim i plote i te gjithë studenteve.</p> <p>Kjo gje i ben mareveshjet e bashkepunimit te realizuara nga institucioni ne sherbim te ketij program studimi mjaft cilesore dhe qe i kane sherbyer vertet kualifikimit te studenteve te ketij program edhe permes punesimit te plote te tyre, vecanerisht ne tregun e turizmit.</p> |
| Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime | Në takimet me Dekanen e Studentëve dhe studentët e programit të studimit, konfirmohet se në procesin e përmirësimit të |

| | |
|---|--|
| <p>studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p> | <p>programeve të studimit përfshihen aktivisht edhe sugjerimet, kërkesat dhe pritshmëritë e studentëve, qoftë përmes raporteve të Njesisë Bazë, qoftë përmes pyetësorëve vlerësues të kryer nga NJZHKC, çdo semester akademik.</p> <p>Njësia bazë disponon dokumentacion të studentëve aktualë dhe atyre të punësuar dhe se kishte kontakte të vazhduara me studentët, kjo u konstatua jo vetëm nga dokumentacioni por dhe gjatë takimit me studentët dhe stafin. Njësia përgjegjëse, Zyra e Karrierës dhe Alumnit dhe Institucioni marrin feedback dhe konsultohen me studentët e diplomuar për të marrë prej tyre sugjerime mbi përmirësime të mundshme të programit të studimit.</p> <p><i>Dok. 10.1 - Marreveshje institucionale</i></p> <p><i>Dok. 20.8 - Punësimi i studentëve Master</i></p> <p><i>Dok. 20.6 - Aktivitetet e zyrës Alumni dhe Karriera me link referues</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p> | <p>Programi i studimit Master Profesional në “MTMAC”, zhvillohet pranueshëm në linjë me kërkesat e tregut dhe në përshtatje me nevojat e institucioneve partnere, qoftë institucione publike, qoftë ente të shërbimit privat si pjesë e planit strategjik të zhvillimit të UniBa. Kjo konfirmohet dhe nga marrëveshjet institucionale dhe vendimin e ngritjes së Bordit të Karrierës.</p> <p><i>Dok. 10.1 - Marreveshje institucionale</i></p> <p><i>Dok. 38. Vendim për krijimin e bordit të karrierës</i></p> |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se institucioni nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre. Përgjegjësi i departamentit e shikon mjaft frytdhënëse bashkëpunimin me industrinë e turizmit dhe partneret e mundshëm në funksion të përmirësimit të programit të studimit. Përmbyshet plotësisht.</i></p> |
| <p>Shkalla e përmbyshjes së</p> | <p>Nuk Përmbyshet Përmbyshet Përmbyshet</p> |


| standardit | mbushet | pjesërisht | kryesisht | plotësisht |
|------------|---------|------------|-----------|------------|
| | | | | X |

| Standardi II.6 | |
|--|--|
| Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. | Bazuar në kurrikulën e programit të studimit konstatohet që ka lëndë të orientuara drejt kërkimit shkencor dhe të aplikuar, por është e nevojshme ndryshimi i disa lëndëve, në masën e lejuar deri në 20% pas procesit të akreditimit. Kjo do reflektohet dhe në përmbushjen e objektivave të programit të studimit, rritjen e kërkimit shkencor dhe të aplikuar të studentëve, gjë e cila lidhet ngushtë dhe me objektivat madhor të IAL. <i>Dok.3 - Rregullore e programit të studimit</i> <i>Dok. 21 - Kërkimi Shkencor UniBa</i> <i>Dok. 21.1. Raporti Shkencor ne DTMR 2021-2022</i> |
| Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. | Ne takimet me drejtuesin e njësisë kryesore/njësisë bazë si dhe stafin akademik pjesë të saj, konstatohet që ka nxitje të vazhdueshme nga ana institucionale për organizimin dhe pjesëmarrjen e stafit në veprimtari të ndryshme shkencor, artistike dhe kulturore që lidhen dhe me kualifikimin e tyre profesional akademik dhe shkencor. <i>Dok. 6 - Dëshmi e respektimit të autonomisë dhe lirisë akademike e financiare</i> <i>Dok. 21 - Kërkimi Shkencor UniBa</i> <i>Dok. 21.1. Raporti Shkencor ne DTMR 2021-2022</i> |
| Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. | Në takimin me studentët u konkludua se stafi akademik i përfshirë në mësimdhënie, në mënyrë të vazhduar motivon dhe nxit studentët për studime konkrete që lidhen me lëndët që ato zhvillojnë në këtë program studimi, nëpërmjet rasteve studimore, detyrave të kursit, konkurseve, pjesëmarrje në panairë etj. <i>Dok. 10.3 - Institucionet e bashkepunimit</i> <i>Dok. 2.4 – Syllabuset e lëndëve</i> |
| Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, | Nga takimi me drejtuesin e njësisë kryesore dhe njësisë bazë në të cilin ofrohet programi i studimi u konstatua që drejtuesit dhe |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme. | administratori i IAL, ka në fokus të tij financimin e kërkimit shkencor dhe të aplikuar, gjë e cila dëshmohet dhe nga raportet financiare të IAL si dhe analiza vjetore e kërkimit shkencor dhe të aplikuar të njësisë bazë dhe ai në nivel IAL. <i>Dok. 28.4 - Raporti financiar vjetor</i> | | | |
| Konkluzione | <i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</i> <i>Por GVJ sugjeron që në funksion të rritjes së kërkimit shkencor ti kushtohet më shumë vëmendje financimit dhe motivimit të stafit të njësisë bazë mbi kërkimin shkencor në fushën e turizmit, duke qenë se është dhe një nga sektorët e rëndësishëm ekonomik në vend.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| Standardi II.7 | |
|--|---|
| Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. | Në takimet me drejtuesin e njësisë bazë u theksua rëndësia që i kushtohet grupeve të caktuara lëndore të këtij program studimi për kërkime më të thelluara shkencore dhe aplikimi në projekte. Kjo vjen në bashkëpunim me strukturat e tjera dhe institutet me të cilat bashkëpunon ngushtë IAL. <i>Dok. 21 Kërkimi Shkencor UniBa</i> <i>Dok. 21.1. Raporti Shkencor ne DTMR 2021-2022</i> |
| Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon | Bazuar në raportin vjetor të kërkimit shkencor në IAL konkludojmë se njësia bazë ka një bashkëpunim me strukturat e tjera të IAL, të cilat janë të fokusuara në projekte kërkimore dhe shkencore, ku stafi i departamentit është i përfshirë sipas grup lëndëve të caktuara (fushat që ato mbulojnë). Në raportin e punës shkencore të njësisë bazë evidentohet kontributi i stafit në |

| | |
|---|---|
| <p>personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p> | <p>projekte që zbatohen nga struktura të tjera që bashkëpunojnë ngushtë me IAL.</p> <p><i>Dok. 21.1. Raporti Shkencor në DTMR 2021-2022</i></p> <p><i>Dok. 21.2 Vendim për përfshirjen e stafit akademik në projekt</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p> | <p>Nga evidencat e paraqitura si dhe takimet në IAL konkludojmë se njësia bazë organizon në mënyrë të vazhduar aktivitete dhe evente brenda dhe jashtë ambienteve të IAL, të cilat janë në funksion të arritjes së objektivave të programit të studimit. Vitin e fundit nuk vihet re organizimi i konferencave nga ana e njësisë bazë, por në rang IAL janë organizuar konferenca, ku 1 sesion i saj i ka qenë kushtuar turizmit dhe sfidave të tij.</p> <p><i>Dok. 21 Kërkimi Shkencor UniBa</i></p> <p><i>Dok. 21.3 - Raportim vjetor i DTMR për vitin akademik 2020-2021</i></p> <p><i>Dok. 21.4 – Raportim vjetor i DTMR për vitin akademik 2021-2022</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p> | <p>Në takimet me studentët konstatuam që ato e kanë gjetur lehtësisht veten në tregun e punës dhe ndjehen komod në punën e tyre.</p> <p><i>Evidenca 30 - Tabelat permbledhese per Aneks RVB, tabela 23</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p> | <p>Nga takimi me drejtuesin e njësisë kryesore si dhe përgjegjësin e njësisë bazë, u shprehën se njësia sapo ka nisur zbatimin e mikrokrediteve në programet e studimit që kanë kaluar akreditimin, në funksion të përgatitjes së studentëve për licensime dhe certifikime ndërkombëtare. Për programin që po vlerësohet akoma nuk ka filluar strukturimi i tyre, por ka lëndë të cilat me përmirësimet e sylabuseve cojnë drejt përgatitjes së tyre për licensime.</p> |
| <p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit</p> | <p>N/A</p> |



| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Evropian (p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU). | | | | |
| Konkluzione | <i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor. Përmbushet plotësisht</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | | | | |
|--|-------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II | përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| | |
|---|---|
| Standardi III.1 | |
| Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Në plan programe janë të përcaktuara format e mësimdhënies, si leksioni, seminari, detyrat si ese, projektet mësimore. Këto janë pjese e sylabusit referuar specifikës që çdo disiplinë ka. Format e vlerësimit të studentëve janë të mirëpërcaktuara në cdo sylabus. Vlerësimi përfundimtar merr në konsideratë të gjithë përbërësit e vlerësimit të studentëve dhe rezultatin e provimit përfundimtar sipas kriterëve të vlerësimit të kursit. <i>Dok. 2 – Dosja e programit te studimit</i> <i>Dok. 11 - Udhëzues për metodat e mësimdhënies</i> <i>Dok.11.1 - Instrumenta vleresimi</i> |
| Kriteri 2. Personeli akademik | Nga evidencat dhe takimet me stafin konstatohet se stafi |

| | |
|--|--|
| <p>respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p> | <p>akademik ishte mjaftueshëm i hapur me studentet dhe në gatishmëri për të ndarë me ta instrumentet dhe cilësinë e vlerësimit. Referuar natyrës së çdo lënde, në vlerësim marrin pjesë shumë faktorë. Pedagogu është i hapur të argumentojë me fakte vlerësimin e studentit. Nëse studenti nuk është prezent, ai ka mundësi që më vonë të kërkojë vlerësimin individual në departament. Sekretaria informon studentët mbi vlerësimet që ata kanë marrë në lëndë të ndryshme gjatë vitit, por edhe në përfundim të semestrave.</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p> | <p>GVJ thekson se IAL mbështet mjaftueshëm stafin akademik, kjo në rrafshin etik dhe profesional. Stafi gëzon hapësirë të mjaftueshme në ushtrimin e lirisë akademike brenda disiplinës që mbulon. Stafi është i lirë të zgjedhë forma bashkëkohore të metodologjisë së mësimdhënies mjaft që të jenë në funksion të disiplinës dhe të përmbushin qëllimet dhe nevojat e studentëve.</p> <p><i>Dok.11.3 – Google Classroom, Manual përdorimi per pedagogët</i></p> <p><i>Dok. 11.8- Te dhena te aktivitetit per kualifikimin e stafit</i></p> <p><i>Dok. 11.6.1-Lista e konferencave, Ëorkshop, Trajnimeve</i></p> <p><i>Dok. 23 - Udhëzues për Tek. Informacionit</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p> | <p>Stafi akademik që mbulon programin e studimit, është mjaftueshëm i përgatitur, me përvojë në fushën e mësimdhënies. Lektorët si dhe asistentë lektorë, përdorin metoda bashkëkohore ku ndërthurin pjesën e teknologjisë në mësimdhënie.</p> <p><i>GVJ sugjeron zgjerimin e stafit me specialistë të fushës së turizmit, të cilët janë më afër industrisë, duke ndikuar dhe në rritjen e mundësive të punësimit dhe aftësimin praktik të tyre.</i></p> <p><i>Dok 31 - CV e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të</p> | <p>IAL konsideron studentët pjesë integrale e vlerësimit, jo vetëm e plan programeve dhe të politikave akademike, por edhe të</p> |



| | | | |
|---|--|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p>studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p> | <p>përmirësimin të metodave të mësimdhënies nëpërmjet sugjerimeve dhe mendimit të tyre kritik në komisionet ad-hoc, në Departament dhe Senatit Akademik ku ata janë të përfshirë.</p> <p><i>Dok. 11.7 -Relacion i vlerësimit të mësimdhënies per vitin akademik 2021-2022</i></p> <p><i>Dok. 11.1.2 -Formular i Punës Semestrare</i></p> <p><i>Dok. 11.2.1 - Raporti i vlerësimit të studentëve 21-22, sem I</i></p> <p><i>Dok. 11.2.2 - Raporti i vlerësimit të studentëve 21-22, sem II</i></p> <p><i>Dok. 17 - Rregullore e Funkcionimit të Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë</i></p> | | |
| <p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p> | <p>IAL organizon trajnime të shpeshta në lidhje me trajnimin e metodat bashkëkohore të mësimdhënies. Stafit akademik përdor metoda interaktive, stimuluese, si dhe kontrolli i dijes bëhet me shkrim dhe/ose me gojë, me detyra kursi dhe me dorëzim dosje. Vlerësimi bëhet me pikë (nga 0-100 pikë) dhe rezultati përfundimtar konvertohet me sistemin kombëtar të vlerësimit me notë, i cili është nga 4 – 10, ku 4 është notë jo kaluese dhe 10 është vlerësimi maksimal për njohuritë e përfituara si dhe shprehet me gërma nga A deri në F, sipas sistemit të vlerësimit ECTS me note.</p> <p><i>Dok. 10.1 - Të dhëna mbi mobilitetin e stafit dhe studentëve</i></p> <p><i>Dok. 11 - Udhëzues për metodat e mësimdhënies</i></p> <p><i>Dok. 11.2 - Guidë instruktive për mbështetjen dhe pasurimin e mësimdhënies online</i></p> <p><i>Dok. 21 - Kërkimi Shkencor UniBa</i></p> <p><i>Dok. 21.1. Raporti Shkencor në DTMR 2021-2022</i></p> <p><i>Dok. 21.2 Vendim për përfshirjen e stafit akademik në projekt</i></p> <p><i>Dok.21.3 - Raportim vjetor i DTMR për vitin akademik 2020-2021</i></p> | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se institucioni ka garantuar procesin e të nxënies dhe aftësimin profesional të shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</i></p> | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |

| Standardi III.2 | |
|---|--|
| Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p> | <p>Nga GVJ rezulton se ekzistojnë procedura transparente të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit përsa i përket vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Mënyra e kontrollit të dijeve është e përcaktuar dhe në sylabusin e cdo lënde. Format e vlerësimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Provimi ndërmjetëm 20 pikë (20%); - Pjesëmarrja aktive në seminar 10 pikë (10%); - Ese / punë në grup 20 pikë (20%); - Provimi përfundimtar 50 pikë (50%). <p><i>Dok. 1.1 – Rregullore e Universitetit</i> <i>Dok. 3 - Rregullore e Programit</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në sylabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p> | <p>Nga evidencat e paraqitura rezulton se ekziston një praktikë e konfirmuar ku javën e parë të semestrit, studentët prezantohen nga pedagogu i lëndës me: - Kompetencat e lëndës - Përshkrimin e lëndës - Rezultatet e mësimnxënies - Metodat e vlerësimit të lëndës - Literatura për zhvillimin e lëndës.</p> <p><i>Dok. 2 – Dosja e programit te studimit</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p> | <p>Format kryesore të mësimdhënies në programin e studimit janë leksionet, seminarët, praktikat, detyrat e kursit, provimet e ndërmjetme të semestrit si dhe provimet përfundimtare.</p> <p>Vlerësimi përfundimtar bëhet pas përfundimit të procesit të korigjimit të provimit si dhe pas mbledhjes së rezultateve të grumbulluara nga studenti përgjatë semestrit, (seminare, testim përgjatë semestrit, ese, detyra kursi etj.), nën përgjegjësinë e titullarit të lëndës</p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>Dok. 2 – Dosja e programit te studimit</i> <i>Dok. 3 - Rregullore e Programit</i> | | | |
| Konkluzione | <i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se institucioni ka hartuar rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | |
|---|--|
| Standardi III.3 | |
| Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | <p>Vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Provimi përfundimtar 50 pikë (50%) - Provimi i ndërmjetëm 20 pikë (20%) - Pjesëmarrja aktive në seminar 10 pikë (10%) - Ese/prezantim/punë në grup 20 pikë (20%) <p>Kjo procedurë, ka bazë legjislative dhe i referohet rregullores së programit të studimit. Studentit i njihet de fakto e drejta e ankimimit në çdo rast.</p> <p><i>Dok. 2 – Dosja e programit te studimit</i> <i>Dok. 3 - Rregullore e Programit</i> <i>Dok. 11.5 – Procesverbal i Vlerësimit semestral</i></p> |
| Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | <p>Rregullorja e Institucionit eviton mundësinë për abuzime apo shmangie të natyrave të ndryshme. Ekziston një procedurë si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lektorit një javë përpara datës së zhvillimit të provimit dorezon tezën për miratim pranë njësisë bazë; - Drejtuesi i njësisë bazë bën miratimin, nënshkrimin, |

| | |
|---|---|
| | <p>vulosjen dhe shumëfishimin e saj;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tezës së provimit të studentit në momentin që zhvillohet provimi i vendoset një kod i cili korespondon me emrin e studentit. - Pedagogu pasi bën korrigjimin e provimeve (jo më shumë se 7 ditë nga dita e zhvillimit të provimit) paraqitet në njësinë bazë ku bën të mundur çkodimin e provimeve dhe hedhjen e rezultateve në procesverbal; <p><i>Dok. 11 - Udhëzues për metodat e mësimdhënies</i></p> <p><i>Dok. 11.2 - Guidë instruktive për mbështetjen dhe pasurimin e mësimdhënies online</i></p> <p><i>Dok.11.3 – Google Classroom, Manual përdorimi per pedagogët</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p> | <p>IAL ka të përcaktuar në Rregulloren Institucionale dhe të programeve të studimit bazën ligjore të zhvillimit të provimeve.</p> <p>Provimi zhvillohet në praninë e dy pedagogëve, ku njëri është titular dhe tjetri asistent. Si hartimi i testit përmbledhës, ashtu dhe protokoli i letrës së vlerësimit firmosen nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p><i>Dok. 3 - Rregullore e Programit</i></p> <p><i>Dok. 2 – Dosja e programit te studimit</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p> | <p>Mbështetur në rregulloren e programit, departamenti ka detyrimin, të ofrojë komente, reagime tek studentët. Vlerësimi i njohurive mund të shoqërohet nga pedagogu përkatës me komente nëse shihet e nevojshme, për të sqaruar studentin si dhe për ta ndihmuar të përmirësohet në të ardhmen. Kjo doli edhe nga kontakti me pedagogët gjatë vizitës në UniBa. Në takimin me ta, u përmend se pedagogu bën konsultime pas provimit, për t'i njohur konkretisht me vlerësimin. Po ashtu, kur kanë pasur ndonjë rast ankese, kanë bërë rishikim të vlerësimit dhe nëse ka qenë rasti edhe ka ndryshuar ky vlerësim. Ndërsa ngritje komisioni ankimimi, deri tani nuk ka pasur, sipas pedagogëve të pranishëm gjatë vizitës në UniBa. Gjithashtu edhe Rregullorja bën përcaktimin në lidhje me korrigjimin e tezave të provimeve, vlerësimin dhe rivlerësimin e tyre</p> <p><i>Dok. 3 - Rregullore e Programit</i></p> <p><i>Dok. 1.1 - Rregullore e Universitetit Barleti</i></p> |

| | |
|---|---|
| | <i>Dok.41 - Model teze e provimit perfundimtar</i> |
| Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | Referuar RVB dhe takimeve në IAL, GVJ konkludon se salla ku zhvillohet provimi monitorohet nga departamenti dhe sekretaria. Nuk lejohet përdorimi i celularëve. Po ashtu nuk lejohet hyrja e individëve që nuk kanë lidhje me provimin. Kodi i etikës së IAL, rregulloret e të gjitha niveleve institucionale nuk e tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyrave. <i>Dok.1.2 - Rregullore e Universitetit Barleti</i> <i>Dok. 3 - Rregullore e Programit</i> <i>Dok. 17.2 - Kodi i Etikës i UniBa</i> |
| Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Kontrolli i dijeve të studentëve konsiderohet proces dhe jo moment. Vlerësimi bëhet në të gjithë instrumentet, me gojë, me shkrim, me pikë me notë dhe konfidencial me studentin për çdo silabus. Rregullorja, i njuh stafit një afat të përcaktuar qartë, lidhur me vlerësimin dhe paraqitjen e rezultateve pranë sekretarisë mësimore. <i>Dok. 3 - Rregullore e Programit</i> <i>Dok. 11.5 – Procesverbal i Vlerësimit semestral</i> |
| Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Studenti, ka të drejtë të njihet me fletën e provimit pas korrigjimit ku bëhet edhe ç'sekretimi i tyre dhe me pikët totale të vlerësimit në tezë në çdo rubrikë. Nëse studenti konstaton se ka rubrika të pakorrigjura apo pikë të pallogaritura në vlerësimin total, gëzon të drejtën të reklamojë provimin në një kërkesë me shkrim, e cila depozitohet pranë sekretarisë mësimore të degës përkatëse, brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve. <i>Dok. 1.2 - Rregullore e Universitetit Barleti</i> <i>Dok. 3 - Rregullore e Programit</i> |
| Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet. | Rregullorja e Institucionit dhe ajo e provimeve, pas ankimimit nga ana e studentit për provimin për arsyet e përmendura më sipër, nëse Drejtuesi i Departamentit, nuk gjen dot zgjidhje, i drejtohet Dekanit të Fakultetit. Dekani, ngrre komision ad hoc në përbërjen e të cilit bëjnë pjesë edhe pedagogët të cilët kanë korrigjuar provimet. Vendimi lidhur me rivlerësimin e provimit merret brenda një jave nga dita e depozitimit të ankesës dhe i bëhet i njohur studentit nëpërmjet sekretarisë mësimore. Vendimi i bashkëlidhet procesverbalit (fletës së provimit) të |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | provimit. <i>Evidenca 1.2 - Rregullore e Universitetit Barleti</i> <i>Evidenca 3 - Rregullore e Programit</i> | | | |
| Konkluzione | <i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit t tyre. Kontrolli i dijeve dhe vlerësimi i studentëve bëhet në mënyrë transparente.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet plotësisht | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | |
|--|---|
| Standardi III.4 | |
| Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve. | Në Rregulloren e Programit të Studimit janë përcaktuar qartë objektivat e këtij programi studimi, të cilat synojnë ofrimin e njohurive të përgjithshme dhe specifike, të mbështetura në lëndë të formimit bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, si edhe plotësuese. Gjithashtu, gjatë bashkëbisedave me stafin dhe studentët konstatuam që stafi akademik kombinon leksionet tradicionale të përqëndruara në teori me: - Pyetje kritike për zgjidhjen e problemeve; - Studimet e rasteve; - Analiza; - Orë mësimore simuluese, etj; <i>Dok. 3 - Rregullore e Programit</i> <i>Dok. 5.1 – Strategjia e zhvillimit te DTMR</i> |
| Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe | Kompetencat profesionale që duhet të fitojnë ata në përfundim të programeve janë fjala kyç që mundëson aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara në kurset e programeve respektive. Kurrikula e programit ofron një ndërthurje të moduleve të cilat aarantojnë rritje të aftësimin profesional të |

| | |
|--|--|
| <p>ndërveprimet (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p> | <p>gërshetuara me teknologjinë dhe inovacionin. <i>Dok. 2 - Dosja e programit te studimit</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p> | <p>Rezultoni se në përfundim të çdo semestri, stafi akademik dorëzon pranë njësisë bazë, raportin e vetëvlerësimit të pedagogut. Ky raport bën të mundur matjen e indikatorëve për realizimin me sukses të lëndës apo modulit përkatës. Në silabuset e çdo lënde studentët kanë informacion në lidhje me kompetencat dhe aftësitë, rezultatet e të nxënit, që marrin në lëndë. Kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti në lëndë mund të evidentohen përmes vlerësimit të studentit, në gjithë treguesit që ka ky vlerësim. Metoda e vlerësimit është ajo e vazhdueshme, gjatë gjithë semestrit ku zhvillohet lënda, nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me gojë dhe/apo shkrim. Vlerësimi final i referohet disa elementëve: vlerësimit përfundimtar, provimit të ndërmjetëm dhe përfundimtar, aktivizimit gjatë seminareve dhe ushtrimeve, si dhe detyrave të kursit, me pikëzimin e mëposhtëm: - Provimi përfundimtar 50 pikë - Provimi i ndërmjetëm 20 pikë - Pjesëmarrja aktive në seminare 10 pikë - Ese/prezantim/pune në grup 20 pikë</p> <p><i>Dok. 21.4 – Raportim vjetor i DTMR për vitin akademik 2021-2022</i></p> <p><i>Dok. 2 Dosja e programit te studimit</i></p> <p><i>Dok. 1.1 - Rregullore e Universitetit Barleti</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të</p> | <p>Nga raporti i RVB si dhe dokumentacioni i paraqitur nga IAL rezultoni se lëndët në programin e studimit Master Profesional në “MTMAC”, në varësi të llojit dhe ngarkesës së tyre janë të organizuara në mënyra të ndryshme. Të gjitha këto lëndë i bashkon fakti që janë të ndërtaura mbi bazë kompetencash. - Zhvillimin e leksioneve - Realizimin e seminareve - Punimin e ushtrimeve - Realizimin e projekteve apo detyrave të kursit etj.</p> <p>Nga bashkëbiseda me studentët, konstatoam që, puna në grup është efikase dhe bëhet për çështje të veçanta. Pedagogët përfshijnë në planin e mësimin punë në grup, punë me projekte, të cilat kërkojnë një bashkëpunim midis studentëve. Kjo i ndihmon studentët të rrisin aftësitë e tyre bashkëpunuese, komunikuese dhe vetbesimin.</p> |



| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | <i>Dok. 3- Rregullore e programit të studimit</i> <i>Dok. 10.1 - Të dhëna mbi mobilitetin e stafit dhe studentëve</i> | | | |
| Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. | Gjatë bashkëbisedimit me studentët konstatuam që organizohen leksione të hapura me ekspertë të fushës, ku student kanë mundësi të vihen në kontakt të drejtpërdrejtë me atë cfarë ofron tregu dhe sfidat me të cilat përballen. <i>Dok. 42 -Aktivitetet e vitit akademik 2021 – 2022</i> | | | |
| Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. | Në dokumentacion strategjik të IAL dhe të programit të studimit rezulton se institucioni dhe njësia bazë mbështet idetë inovative të studentëve dhe u krijon mundësi për mbështetje financiare në projekte kërkimore e studime të avancuara nëpërmjet instituteve të Grupit Barleti. Kjo është e theksuar edhe në analizën vjetore të departamentit si dhe anagzhimin e tyre në projekte në fushën e turizmit. Por nuk konstatohet pjesëmarrje të studentëve në konferenca shkencore dhe raste të botimeve të tyre. <i>Dok.43 – Angazhimi i studentëve në projekte</i> | | | |
| Konkluzione | <i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se institucioni ka ngritur strukturat përkatëse për garantimin e rritjes s aftësive krijuese dhe zbatuese tek studentët, duke i motivuar ato dhe në kërkimin shkencor dhe të aplikuar.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|---|
| <p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p> | <p>GVJ konstaton se institucioni ka hartuar procedure të posaçme për provimin përfundimtar. Ky program studimi mbyllet me mbrojtjen e provës finale para komisionit të posaçëm që ngrihet nga departamenti për këtë qëllim, në rastet kur studentet kanë një mesatare 9.5. Ndërsa, në rastet kur studenti nuk ka një mesatare të tillë, e përfundon programin e studimit me provim përfundimtar. Kjo bazuar në rregulloren e institucionit, si dhe programit të studimit. Studentët njihen heret me këtë detyrim dhe hapat që duhen përbushur. <i>Dok. 3 - Rregullore e programit</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p> | <p>Konfirmojmë që, studentët kanë mbështetje të vazhdueshme nga stafi akademik për të përbushur hap pas hapi provën finale. Për këtë, Departamenti, ka vënë në dispozicion të studentëve një manual udhëzues Paketa e Provës Finale.</p> <p><i>Dok. 13.2 Programi për provimin e diplomimit në MP</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p> | <p>Nga dokumentacioni i dorëzuar konstatohet që paketa e provës finale ka në përmbajtjen e saj udhëzime për procedurat e përgatitjes, udhëheqjes, të monitorimit, të prezantimit dhe të vlerësimit të punimit të provës finale. Po ashtu në paketë janë renditur përgjegjësitë e secilës palë që përfshihet në realizimin e kësaj veprimtarie. Komisioni i vlerësimit të provës finale e mbështet punën e tij në procedurat e hollësishme të Paketës së provës finale. Kjo paketë i shërben si pedagogëve, ashtu edhe studentëve.</p> <p><i>Dok. 3 - Rregullore e programit</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës</p> | <p>Në rregulloren e programit të studimit është e parashikuar që personeli akademik duhet të udhëheq temat e diplomave, dhe të udhëzojë studentët për zgjedhjen e temës, literaurën, etj, për studentët të cilët përbushin kriterin e mesatares, por nuk konstatohet që të ketë pasur raste të provës finale me punim diploma.</p> <p><i>Dok. 1.3 - Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030</i></p> <p><i>Dok. 13.2 - Programi për provimin e diplomimit në MP</i></p> |

| | |
|---|---|
| <p>sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p> | |
| <p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p> | <p>Ndonsëse është e përcaktuar në rregullore nuk është konstatuar rast i shlyerjes së provës finale me punim diplome.</p> <p><i>Dok. 3 - Rregullore e programit</i></p> |
| <p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p> | <p>Diploma, shoqëruar me suplementin është hapi i fundit. Studenti pajiset me diplomën, suplementin e diplomës, si dhe listën e notave të lëshuara nga UniBa dhe të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit në Republikën e Shqipërisë, pastaj vijojnë hapat e tjerë drejt licensimit deri në punësim, hapa për të cilët insitucioni vazhdon të jetë i informuar.</p> <p><i>Dok. 3. Rregullore e programit</i> <i>Dok. 2.2 - Paketa e proves finale</i></p> |
| <p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p> | <p>Diploma, shoqëruar me suplementin është hapi i fundit. Studenti pajiset me diplomën, suplementin e diplomës, si dhe listën e notave të lëshuara nga UniBa dhe të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit në Republikën e Shqipërisë, pastaj vijojnë hapat e tjerë drejt licensimit deri në punësim, hapa për të cilët insitucioni vazhdon të jetë i informuar.</p> <p><i>Dok. 1.1 - Rregullore e Universitetit Barleti, Neni 101</i></p> |
| <p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p> | <p>Sekretaria Mësimore menaxhon dhe administron të gjithë informacionin e studentëve ndër vite. Të gjitha të dhënat e studentëve, që nga fillimi i studimeve deri në diplomimin e tyre gjenden në databaset e Sekretarisë Mësimore, si dhe në regjistrin themeltar të notave. Sekretaria Mësimore arkivon dhe mban në dosje dokumentat e çdo studenti që është i regjistruar, është çregjistruar, si dhe të studentëve që kanë mbaruar studimet e tyre.</p> <p><i>Dok. 19.2 - Rregullore për Funkcionimin e Sekretarisë</i></p> |

| | | | | |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>Mësimore</i> <i>Dok. 24 - Rregullore Protokoll Arkiva Uniba</i> | | | |
| Konkluzione | <i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit n përogramin e studimit si dhe e pajis studentin me dokumentacionin përkatës pas përfundimit të studimeve.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes sëstandardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |


| | |
|---|---|
| Standardi III.6 | |
| Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale. | Në funksion të përfimit të njohurive, njësia përgjegjëse garanton mjedise brenda dhe jashtë institucionit për realizmin e praktikës profesionale të bashkërenduara me institucionet partnere ku studentët kryejnë këto praktika. Orët e praktikës profesionale kanë 6 ECTS dhe ekuivalentohen me 135 orë. Praktikrat profesionale zhvillohen në institucione shtetërore ose private, sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin pedagogut mentor të programit. <i>Evidenca 10.1 - Marrëveshje institucionale</i> <i>Evidenca 10.3 - Institucionet e bashkëpunimit</i> |
| Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale. | Rezulton se njësia bazë ka nënshkruar 10 marrëveshje bashkëpunimi me biznese që operojnë në sektorin e turizmit, në të cilat zhvillohet praktika profesionale. Në këtë aspekt, sugjerojmë zgjerimin e marrëveshjeve, për të patur nje efikasitet më të lartë të zhvillimit të procesit si një menaxhim më cilësor të burimeve njerëzore. <i>Dok. 10.1 – Marrëveshje institucionale</i> <i>Dok. 30.2 – Relacion për infrastrukturën</i> <i>Dok. 23 - Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit UniBa</i> |

| | | | | |
|---|--|-----------------------|----------------------|--------------------------------|
| Kriteri 3. Praktikët profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës. | Orët e praktikës profesionale, kanë peshën që ofron ligji dhe ekuivalentohen me 135 orë në totalin e ngarkesës së mësimdhënies, duke përbërë elementin me peshën specifike përkatëse në procesin e formimit, në përputhje me objektivat e formimit dhe strategjinë zhvillimore të këtij programi. <i>Dok. 2 – Dosja e programit të studimit</i> <i>Dok. 2.3 - Paketa e praktikës</i> | | | |
| Konkluzione | <i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se institucioni një procedurë të qartë për zbatimin e njohurive nëpërmjet praktikës si dhe ka marrë të gjitha masat për lidhjen me industrinë e turizmit, në funksion të marrjes së njohurive praktike si dhe punësimit të studentëve pas diplomimit.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet plotësisht | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht X |

| | | | | |
|---|-----------------------|-----------------------|----------------------|--------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III | Përmbushet plotësisht | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht X |
|---|-----------------------|-----------------------|----------------------|--------------------------------|

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| | |
|--|--|
| Standardi IV.1 Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat | Për të realizuar objektivat e programit të studimit Master Profesional “Menaxhim në Turizëm, Mikëpritje dhe Aktivitete Çlodhëse”, të hartuara nga UniBa, angazhohet personeli Administrativ si dhe ai Akademik. Rekrutimi i Personelit Akademik kryhet sipas proceduarve ligjore në përputhje me Statutin dhe rregulloret e Institucionit. |

ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Personeli akademik dhe administrativ i programit të studimit Master Profesional “Menaxhim në Turizëm, Mikëpritje dhe Aktivitete Çlodhëse” është i përzgjedhur për të përmbushur objektivat e programit. Personel akademik është i specializuar në fushat përkatëse të shkencës për të dhënë leksionet dhe seminarët e programit, që janë specifike për këtë program.

GVJ vlerëson gjetjet, edhe gjatë takimeve me pedagogët, se mbulueshmëria e lëndëve në programin e studimit përgjithësisht është me mësimdhënës me grada shkencore Doktor i shkencave dhe Msc. Me tituj akademikë angazhohet vetëm një personel akademik me kontratë.

GVJ konstaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në realizimin e programit të studimit, bazuar në (tabelat 6.1 – 6.2 të Evidenca 30) është:

1. Për vitin akademik 2021- 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 8 pedagogë nga të cilët 5 PAE dhe 3 PAK (62.5 % /37.5 %)
2. Për vitin akademik 2022- 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 8 pedagogë nga të cilët 5 PAE dhe 3 PAK (62.5 % /37.5 %)

| Tituj/grada | 2022-2023 | | 2021-2022 | |
|-----------------|-----------|----------|-----------|----------|
| | PAE | PAK | PAE | PAK |
| Prof Dr | - | - | - | - |
| Prof.Assoc | - | 1 | - | 1 |
| Dr/Doc | 5 | 1 | 5 | 2 |
| Msc | 0 | 1 | - | - |
| Ne total | 5 | 3 | 5 | 3 |



Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Bazuar në planin mësimor të miratuar në fillim të çdo viti akademik, bëhet shpërndarja e ngarkesës. Nga verifikimi i të dhënave statistikore, ngarkesa mësimore është mbajtur nga personeli akademik efektiv, sipas të dhënave më poshtë. Përballimi i ngarkesës mësimore të PS Master Profesional në “Menaxhim në Turizëm, Mikëpritje dhe Aktivitete Çlodhëse” realizohet nga personeli akademik efektiv sipas



| | |
|---|---|
| | <p>përcaktimeve ligjore.</p> <p>Pasi analizuam informacionin e dhënë në tabelën 12.1 të <i>Evidenca 30</i>, për ngarkesën mësimore të personelit akademik PAE dhe PAK rezultoi se raporti i ngarkesës mësimore (orë mësimore) PAE / PAK është si më poshtë:</p> <p>2021-2022 - 76 % / 24 %</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p> | <p>UniBa dëshmon qëndrueshmëri të personelit akademik të angazhur në programin e studimit, por nuk e shoqëron atë me dokumentacion në lidhje me kontarta e punës dhe dokumente të tjera që lidhen me përmbushjen e detyrimeve për mbulimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.</p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> | <p>Institucioni realizon vlerësim dhe përzgjedhje të personelit mbështetur në procedurën me katër faza.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Në fazën e parë, kryhet shpallja e pozicionit të lirë të punës; 2. Në fazën e dytë vlerësimi me dosje duke krijuar një databazë të aplikantëve; 3. Në fazën e tretë kryhet vlerësimi paraprak i aplikantëve nga një komision i përbërë nga Administratori, Sekretari i përgjithshëm, Drejtuesi i zyrës së mmenaxhimit dhe Administrimit të performances; 4. Në fazën e katërt intervista e ndarë në dy faza <ul style="list-style-type: none"> • takimi paraprak • intervista nga komisioni, intervista me gojë në prani të komisionit të ngritur. <i>Evidenca 7</i> <p>Kriteret që duhet të plotësojë kandidati janë:</p> <p>Kriteret të përgjithshme;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të ketë përfunduar studimet universitare në fushën përkatëse, sipas notës mesatare të përcaktuar në aktet ligjore; |




| | |
|---|--|
| | <ul style="list-style-type: none"> • Të ketë diplomë Master i Shkencave në fushën e kërkuar me notë mesatre të përcaktuar në aktet ligjore; • Kandidati duhet të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj të mbrojtur dhe vërtetuar me dëshmi nga UT ose institucione të njohura ndërkombëtare; • Të ketë të paktën 1 vit përvojë pune ose në mësimdhënien univeristare në fushën që do të mbulojë; • Të ketë të dokumentuar veprimtari kërkimore shkencore të fushës përkatëse; • Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata; • Strukturat përgjegjëse në institucion zhvillojnë procedurën duke iu përmbajtur nevojave për staf akademik sipas profileve të kërkuara nga njësitë bazë. <p>GVJ konstatoi në kontrollin e dosjeve të aplikantëve që këto kritere zbatoheshin me korrektësi.</p> <p><i>Evidenca 7;</i></p> <p><i>Takimi me Drejtuesin e Drejtorisë Juridike dhe të Burimeve Njerëzore; RVB</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p> | <p>GVJ gjatë vizitës në ambientet e Universitetit, përkatësisht laboratorëve, të cilët përdoren nga studentët, u shoqërua dhe u informua nga stafi ndihmës i universitetit (departamentit), i cili merrej ekskluzivisht me punën e laboratorëve. Kishte 3 laboratorë në dispozicion të PS, të paisur në kuadrin e realizimit të projekteve të objektivave të programit të studimit. Mirëmbajtja e pajisjeve laboratorike ishte në nivel shumë të mirë.</p> <p><i>RVB;</i></p> <p><i>Shënimet nga vizita në institucion.</i></p> |
| <p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të</p> | <p>Të dhënat e institucionit për angazhimin e personelit akademik janë dhënë për një periudhë kohore 3-vjeçare, respektivisht për vitet akademike:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. VA.2019-2020 2. VA.2020-2021 3. VA.2021-2022 |





| | |
|--|--|
| <p>përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p> | <p>Personeli akademik efektiv dhe me kontratë në 2 vitet e fundit (për 2020-2021 ky program nuk ishte hapur), rezulton me të dhënat si më poshtë:</p> <p>Referuar (<i>Evidenca 30, tabelat 6.1 dhe 6.2</i>) GVJ konstaton se, numri i personelit akademik efektiv dhe me kontratë të angazhuar në këtë program studimi është i njëjtë për periudhën dy vjeçare 2020-2022 dhe në përputhje me profilin e programit të studimit në të cilin kontribuojnë. Gjithashtu në të dhënat e vëna në dispozicion nga institucioni jepet informacion edhe për angazhimin në procesin e mësimdhënies së çdo anëtari të DMTRE sipas semestrave dhe vitit akademik. Krahas personelit akademik efektiv, për realizimin e objektivave të programit të studimit ushtrojnë detyren edhe koordinatorja e programit. Për personelin ndihmës akademik nuk ka të dhëna.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se në në zyrën e burimeve njerëzore dosjet e personelit akademik si me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme ishin të plota. Institucioni kishte një dokumentacion të ruajtur dhe të përditësuar me të dhënat e stafit akademik i cili ishte i angazhuar në kuadër të këtij program studimi.</p> |
| <p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p> | <p>UniBa dhe DMTRE kanë të angazhuar personel të kualifikuar dhe me njohuri multidisiplinore në përputhje me fushën e studimit, i cili është përgjegjës edhe për zhvillimin e praktikës profesionale.</p> <p>UniBa ka marrëveshje bashkëpunimi me institucionet qendrore, vendore dhe sipërmarrje private për realizimin e praktikës profesionale (Agjensia Kombëtare e Turizmit, Sondor Travel Albania, Kompania Mondial, Mak Albania, Bashkia Mat etj)</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion;</i> <i>Evidencat 30, Tabela 5;</i></p> |
| <p>Kriteri 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të</p> | <p>Në manualin e praktikës profesionale të hartuar për, praktikatat profesionale të ciklit të studimit master në UniBa, është e përcaktuar në formën e një formulari angazhimet e personelit mbikqyrës për realizimin e praktikës profesionale. Ky personel ka si detyrë vlerësimin e studentit për 20 tregues të përmbledhur</p> |

| | | | | |
|--|---|------------------------------------|-------------------------------------|-----------------|
| <p>marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p> | <p>në formular dhe asiston studentin në hartimin e raportit përfundimtar.</p> <p>Evidenca 2.3</p> | | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se institucioni përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies në MP në “Menaxhim në Turizëm, Mikëpritje dhe Aktivitete Çlodhëse”</i></p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> | <p>X</p> |

| <p>Standardi IV.2</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</p> | |
|---|---|
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p> | <p>Departamenti i Turizmit, Mikëpritjes dhe Rekreacionit zhvillon procesin mësimor në mjediset e FSHTS, i cili ndodhet në mjediset e Kampusit 2 të UniBa. Kampusi 2 ku ndodhet godina e FSHTS ka sipërfaqe m²/njësi 2514 m² dhe ka në dispozicion 9 laboratorë në katin përdhe, të parë, të dytë dhe të tretë, 7 klasa, 1 laborator + klasë, të cilat shërbejnë për leksione dhe seminare. Klasat janë të paisura të gjitha me video projektorë po ashtu edhe sallat e Bibliotekave si ajo në holl dhe ajo shkencore.</p> <p>Nga vizita në instiucion grupi i GVJ konstaton se mjediset e përshkruara në dokumentacion ishin të mjaftueshme dhe të përshtatshme për realizimin e proceseve akademike. Institucioni ka salla të kapaciteteve të ndryshme të ndara në salla leksionesh dhe seminaresh të cilat plotësojnë realizimin e objektivave mësimore në funksion të 6 studentëve që ka ky program.</p> |






| | |
|--|--|
| | <p>Studentët e programit kanë patur në dispozicion një infrastrukturë fizike, didaktike dhe logjistike për përmbushjen e realizimit si të orëve teorike ashtu edhe moduleve specifike.</p> <p><i>Evidenca 30;</i></p> <p><i>Evidenca 30.2</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p> | <p>Në UniBa, mjediset mësimore ku zhvillojnë procesin mësimor studentët e programit, garantonin realizimin e procesit mësimor. Ato janë të pajisur me smartboard dhe sistemem projektimi digjital, përfshirë edhe të gjitha mjetet e tjera audio dhe video. Laboratorët janë të pajisur me kompjutera, priter/fotokopje/skaner, projektor. Institucioni ka një numër të konsiderueshëm laboratorësh.</p> <p><i>Evidenca 30;</i></p> <p><i>Evidenca 30.2;</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p> | <p>Dokumentacioni argumentues që shoqëron RVB tregon se institucioni ka një numër të madh laboratorësh janë të pajisur me kompjutera, priter/fotokopje/skaner, projektor, softëare ArtGIS 10.4 për hartimin e itinerareve turistike dhe digjitalizim e potencialeve turistike.</p> <p><i>RVB;</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p> | <p>GVJ konfirmoi se mjedisi logjistik dhe në veçanti infrastruktura didaktike ishte e aksesueshme në çdo kohë, për studentët dhe stafin akademik. Për realizimin e detyrave të studentëve të programit MP bashkëpunohet edhe me tri laboratorët e teknologjisë së informacionit, të cilët e mbështesnin fort këtë program studimi. <i>Vizita në Institucion</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që</p> | <p>Kapacitetet e UniBa dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera mundësojnë mjedise të përshtatshme për</p> |



| | | | | |
|---|---|-----------------------------|----------------------------|---|
| <p>zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.</p> | <p>realizimin e veprimtarive praktike dhe aktiviteteve të tjera. Mjediset mësimore si klasa, auditorë e laboratorë mundësojnë realizimin e procesit mësimor.</p> <p>Nga vëzhgimi i drejtëpërdrejtë i auditorëve, laboratorëve, programeve të reja kompjuterike, bibliotekës gjatë vizitës u konstatua se mjediset mësimore dhe ato ndihmëse janë të pajisura me lidhje interneti dhe me pajisje elektronike të teknologjisë së informacionit duke siguruar përdorimin e metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies/mësimnxënies në varësi të numrit të studentëve dhe grupeve mësimore teorik dhe praktik mësimor.</p> <p><i>RVB</i> <i>Vizita në institucion</i></p> | | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se institucioni vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së MP në “Menaxhim në Turizëm, Mikëpritje dhe Aktivitete Çlodhëse”. GVJ shpreh vlerësimin: Përbushet plotësisht.</i></p> | | | |
| <p>Shkalla e përbushjes së standardit</p> | <p>Përbushet</p> | <p>Përbushet pjesërisht</p> | <p>Përbushet kryesisht</p> | <p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |

| | |
|--|--|
| <p>Standardi IV.3</p> <p>Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe</p> | <p>Literatura bazë dhe ndihmëse që vihet në dispozicion të programit MP në “Menaxhim në Turizëm, Mikëpritje dhe Aktivitete Çlodhëse” është në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Ajo gjendet si në formë fizike ashtu edhe në formë digjitale. Totali i titujve të vënë në dispozicion për këtë program është 4.250 tituj. Gjatë vizitës GVJ u njoh me hapësirën e titujve</p> |

| | |
|---|--|
| <p>njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p> | <p>të librave për turizmin dhe konfirmoi që ato janë pasuruar dhe ishin në shërbim të natyrës së lëndëve që zhvillohen në këtë program.</p> <p><i>RVB;</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p> | <p>Përgjegjësit e programit të studimit përmes kërkesave të marra nga personeli akademik me titujt e propozuar i përcjellin ato bibliotekës së UniBa. Nga takimi që patëm me punonjësen e bibliotekës na u konfirmua fakti që institucioni i merr në konsiderat kërkesat e stafit akademik dhe realizimi i procedurës për pasurimin e fondit realizohet në mënyrë periodike.</p> <p><i>RVB;</i></p> <p><i>Takimi me punonjësen e bibliotekës</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p> | <p>Në nivel universiteti, UniBA vendos në shërbim të studentëve Bibliotekën Universitare në dy Kampuset 1 dhe 2. Biblioteka e FSHTS garanton të drejtën e çdo studenti për, aksesim të bibliotekës përmes procedurës së regjistrimit dhe hapjes së kartelës për shfrytëzimin e literaturës fizike dhe ambjenteve të mjediseve të brendëshme dhe të jashtëme të saj. Gjithashtu studentët mund të shfrytëzojnë shërbimin e internetit nga mbulimi i të gjithë hapsirës së bibliotekës me rrjetin Eëireless dhe të aksesohen në biblioteka on-line.</p> <p><i>RVB;</i></p> <p><i>Evidenca 40;</i></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të</p> | <p>Biblioteka që është në shërbim të programit të studimit MP në MTMAÇ e ka njësinë qendrore në katin e përë me sipërfaqe 27.3 m² ka 5 250 tituj dhe 18 vende leximi dhe ka infrastrukturë për aksesimin e titujve të librave në bibliotekat online. Po brenda Kampusit 2 biblioteka zgjerohet në katin përdhe në një tjetër hapësirë prej 95.1 m² me 50 vende leximi. Kjo njësi është e paisur më revista shkencore, pinime të konferencave, periodikë të fushës së turizmit, rekreacionit dhe menaxhimit të eventeve</p> <p><i>RVB;</i></p> <p><i>Evidenca 40;</i></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p> <p>Gjatë vizitës GVJ u njoh konkretisht me fondin e titujve të</p> |






| | |
|--|---|
| studimit. | <p>librave në shërbim të programit të studimit.</p> <p><i>GVJ rekomandon shtimin e titujve të librave në gjuhë të huaj të pesë viteve të fundit.</i></p> |
| Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. | <p>UniBa krijon kushte për akses të barabartë dhe pa pagesë për studentët e programit në bibliotekat on-line. Gjatë vizitës në institucion punonjësja e bibliotekës konfirmoi duke na stimuluar një rast konkret për akses në këto biblioteka.</p> <p><i>Vizita në Insitucion;</i></p> <p><i>Takimi me punonjësen e bibliotekës.</i></p> |
| Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. | <p>Biblioteka në Kapusin 2 ku edhe zhvillohet program i studimit ka një fond prej librash me karakter revista shkencore, punimet e konferencave, periodikë të fushave të ndryshme dhe 50 poste leximi dhe poste me kompjutera për ofrimin dhe aksesimin e bibliotekës digjitale të universitetit dhe të bibliotekave on-line ndërkombëtare si, Econ Biz, Research4life, Hinari, AGORA, OARE, ARDI, JTSOR, GOALI. Të gjithë studentët e këtij programi janë anëtarë të bibliotekës. Menaxhimi i bibliotekës kryhet nëpërmjet platformës on-line Për shkak të pandemisë, UniBa ka shfrytëzuar qasjen në biblioteka digjitale, duke u ofruar punonjësve dhe studentëve të tij falas gamën e gjerë të librave në bibliotekat elektronike</p> <p><i>Evidenca 40.1;</i></p> <p><i>Evidenca 40.2;</i></p> <p><i>Vizita në institucion takimi me punonjësen e bibliotekës</i></p> |
| Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | <p>Biblioteka qëndron e hapur nga e hëna në të shtunë. Përgjatë javës orari i funksionimit të bibliotekës është 8.00-19.45. Kërkesat për libra nga studentët dhe personeli kryen në harkun kohor 8.00-16.30. Oraret e bibliotekës ishin në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor. Gjithashtu studentët kishin mundësinë të tërheqin literaturë për shfrytëzim jashtë ambienteve të bibliotekës. <i>Takimi me punonjësen e bibliotekës;</i></p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se studentët kishin mundësi të shfrytëzonin bibliotekën gjatë hapsirave të lira kohore dhe të aksesoheshin në biblioteka on-line deri në orarin e mbylljes së saj.</p> |
| Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të | <p>Pasurimi i fondit me literaturë dhe dhe rritja e aksesimit në bibliotekat on-line është politik e UniBA. Drejtuesi i njësisë</p> |





| | | | | |
|--|---|-------------------------------------|------------------------------------|---|
| <p>programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p> | <p>bazë bashkëpunon me punonjëset e bibliotekës për monitorimin e vazhdueshëm të shfrytëzimit të bibliotekës nga studentët e programit të studimit. Gjatë vizitës në institucion, në vizitën në bibliotekë u njohëm me kartela të studentëve dhe personelit akademik, të cilat e dëshmonin shakallën e mjaftueshme të shfrytëzimit.</p> <p><i>RVB</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p> | | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se institucioni përmban literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme) në MP në “Menaxhim në Turizëm, Mikëpritje dhe Aktivitete Çlodhëse”.</i></p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |

| <p>Standardi IV.4</p> | |
|--|--|
| <p>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me</p> | <p>UniBa ka hartuar një udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit. Ky dokument është në funksion të menaxhimit të të dhënave, komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm dhe gjithë procedurat rregullat dhe politikat përkatëse, ai përmban çështje si Portali Studentor. Sistemi i menaxhimit të të</p> |






| | |
|---|---|
| <p>studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p> | <p>dhënave të studentëve SIS Classter, Google Classroom, Intranet dhe GSuit për komunikim të brendshëm, Webfaqja zyrtare e UniBa dhe nënfaqet e grupit Barleti. Sistemi mundëson informimin në kohë reale të studentëve lidhur me rezultatet e tyre dhe rrit përgjegjshmërinë e pedagogëve për vlerësimin e studentëve dhe transparencën për të gjithë procesin. Në kushtet konkrete të ndërprerjes disa mujore të mësimin në auditor, realizimi i mësimin online është mundësuar nëpërmjet platformave të ndryshme. U përdorën gjerësisht gjatë vitit akademik 2019-2020 platformat Google Clasroom, Skype dhe Hangout Meet. Gjithashtu është konstatuar se institucioni ka hartuar një document në formën e një guide instructive për mbështetjen dhe pasurimin e mësimin on-line gjatë periudhës së pandemisë.</p> <p><i>Evidenca 11.3</i></p> <p><i>Evidenca 44. Aneks 1, 2, 3, 4</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> | <p>Sistemi Intranet mundëson komunikimin e brendshëm, informacionin dhe materialet që lidhen me procesin mësimor ndërmjet stafit akademik dhe studentëve në kohë reale. Ky sistem mundëson lehtësira si për studentët pasi ata informohen mbi rezultatet e testimit, njoftime, materialet e lëndëve etj ashtu edhe për stafin akademik që dokumenton punën e tij përmes sistemit. Një tjetër aspekt i rëndësishëm që menaxhohet dhe administrohet nga ky system është dhe veprimtaria e sekretarisë mësimore duke plotësuar bashkëpunimin e të tre komponentëve Student/sekretari mësimore/personel akademik.</p> <p><i>Evidenca 44. Aneks 4;</i></p> <p><i>RVB;</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p> | <p>UniBa përmes sistemit të menaxhimit që përdor, në bazë të programeve të studimit mundëson aksesin e dedikuar për stafin dhe studentët. Përmes sistemit G Suit, Intranet institucioni mundëson dokumentacionin dhe komunikimin midis studentëve dhe stafit. Përdormi në nivel institucional i këtij sistemi mundëson monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konsatoi se format e mbështetjes së sistemit për personelin akademik ishin:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Publikimi online i kurrikulës së programit të studimit, |





| | |
|---|---|
| | <ul style="list-style-type: none"> - Monitorimi i planit mësimor, - Regjistrimi në sistem i personelit akademik përgjegjës për lëndën/modulin dhe atë ndihmës mësimor, <p>Raportimi mbi ecurinë e plotësimit të afateve të përcaktuara në Manual</p> <p>Format e mbështetjes për studentët ishin:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ngarkimin e detyrave të kursit, - Ngarkimin e projekteve - Marrjen e leksioneve të ngarkuara nga personeli akademik - Marrjen e vlerësimeve <p>Personeli ndihmës akademik ndihmon studentët duke ju vënë në dispozicion një sekretari online në kohë reale dhe nga çdo vend, për t'iu bërë të ditur:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Grafikon e provimeve - Notat e provimeve - Lajmërim apo informacione të dërguara nga pedagogët apo departamenti - Vërtetime të ndryshme <p><i>RVB;</i></p> <p><i>Evidenca 44. Aneks 1, 2, 3, 4</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p> | <p>Në UniBa krahas sistemit Intranet është përdoruar edhe SIS Claster. Ai ka krijuar mundësinë e komunikimit interaktiv dhe në kohë reale. Përmes kësaj platforme realizohen shkëmbime të informacionit midis stafit akademik dhe studentëve. Platforma Microsoft Team mundëson monitorimin e aktivitetit akademik nga strukturat e NJSBC-së dhe jo vetëm. Nëpërmjet kësaj platforme merren të dhëna dhe realizohen raporte mbi aktivitetin e përdorimit të saj nga anëtarët e personelit akademik. Manual i përdorimit të SIS Claster për studentët.</p> <p><i>RVB</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e</p> | <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues të programit të studimit MP në “Menaxhim në Turizëm, Mikëpritje dhe Aktivitete Çlodhëse” GVJ konstatoi se sistemi Portali Studentor</p> |


| <p>administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p> | <p>kontrollon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Autenticitetin e informacionit identifikues të përdoruesit; - Autorizon aksesin e përdoruesit në të gjitha funksionet/operacionet; - Ruan privatësinë e të dhënave; <p>Nëpërmjet këtij sistemi institucioni mund të monitoroj në kohë reale aktivitetin mësimor të personelit akademik dhe administrativ. Me të dhënat reale të grumbulluara mund të hartohen raporte monitorimi rreth performancës së procesit mësimor si nga personeli akademik, ndihmës por edhe pjesëmarrjes së studentëve në frekuentimin dhe zhvillimin e procesit mësimor. Të dhënat e grumbulluara iu vihen në dispozicion titullarëve të njësisë kryesore edhe të njësisë bazë. Nga databaza e krijuar krijohet një panoramë e qartë rreth hedhjes në kohë të dokumentacionit të kërkuar, përmbushjen e kritereve të vlerësimit dhe respektimin e afateve të hedhjes së rezultateve online. Sistemi Portali Studentor ka aksesin e tij nga faqja zyrtare e internetit të UniBa. <i>Evidenca 44. Aneks 5, 5.1</i></p> | | | | | | | | |
|---|--|----------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|--|----------|
| <p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p> | <p>GVJ hyri në faqen e internetit të UniBa dhe konstatoi që ajo mund të konfirmojmë informacionin e kërkuar lidhur me gjuhën e hedhjes së informacionit në internet.</p> | | | | | | | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se institucioni disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit në MP në “Menaxhim në Turizëm, Mikëpritje dhe Aktivitete Çlodhëse”.</i></p> | | | | | | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="550 1713 750 1814"></th> <th data-bbox="750 1713 981 1814">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="981 1713 1189 1814">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1189 1713 1402 1814">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="550 1814 750 1870"></td> <td data-bbox="750 1814 981 1870"></td> <td data-bbox="981 1814 1189 1870"></td> <td data-bbox="1189 1814 1402 1870" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table> | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | X |
| | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | | |
| | | | X | | | | | | |

| Standardi IV.5 | |
|--|--|
| Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | GVJ bazuar në RVB konstaton se raporti financiar hartohet në nivel institucioni çdo vit. Ai kryhet nga zyrat e financës nën drejtimin e Administratorit të deleguar të UniBa. Raportet përmbajnë të dhëna të hollësishme për llogaritjen e kostove të programit dhe plani për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për një cikël të plotë studimi. <i>Evidenca 28.4</i> |
| Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. | Mbështetur në Planin e financimit të programit burimet e financimit të programit në UniBa janë: <ul style="list-style-type: none"> - Konsulencat, shërbimet; - Tarifa për dhe gjatë shkollimit; - Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm); - Të tjera (qera, ndryshime të kursit valuator, interesa bankare); - Donacionet dhe projektet; Në dokument paraqitet ecuria e këtyre zërave për vitet 2018, 2019, 2020. Nga të dhënat vihet re një rritje e treguesve të mësipër me të cilët justifikohet mbështetja financiare. <i>Evidenca 28</i> |
| Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e | Bazuar në RVB, UniBa kryen auditim të brendshëm periodik nga njësia e auditimit të brendshëm të këtij institucioni. Brenda dy javëve raporti paraprak i dorëzohet Administratorit, Raporti |

| | |
|---|---|
| <p>financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p> | <p>përfundimtar i dërgohet menaxhimit të institucionit.</p> <p>Krahas auditimit të brendshëm institucioni i nënshtrohet edhe një auditimi të jashtëm nga kompania Grant Thornton. Kjo kompani ndërkombëtare çertifikon pasqyra financiare.</p> <p><i>RVB</i></p> <p><i>Evidenca 28</i></p> <p><i>Evidenca 28.1</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p> | <p>Bazuar në RVB raportet përmbajnë transparencë përsa i takon kontabilizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve. Në nivel institucioni raportet janë periodike, të përvitshme. Sikundër është theksuar dhe më lartë për këtë program studimi nuk ka një raport specifik financiar.</p> <p>Këto raporte bëhen me dije deri në nivelin e njësisë bazë dhe për masën e realizimit të buxhetit të miratuar.</p> <p><i>Takimi me drejtuesin e njësisë, vizita në institucion</i></p> <p><i>RVB</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.</p> | <p>UniBa si institucion jopublik i arsimit të lartë i siguron burimet e financimit nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Konsulencat, shërbimet; • Tarifa për dhe gjatë shkollimit; • Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm) • Të tjera (qera, ndryshime të kursit valuator, interesa bankare); • Donacionet dhe projektet; <p>Referuar RVB UniBa siguron qëndrueshmëri financiare për gjatë gjithë kohës që zhvillohet program i studimit.</p> <p>GVJ, bazuar në vizitën në institucion dhe takimin me përfaqësues të GVB dhe Stafin Akademik, u informua se politika e mbështetjes mundësohet nga qëndrueshmëria financiare dhe forma e menaxhimit të qëndërzuar duke mundësuar shpërndarjen e kostove në nivel institucion. <i>Takimi në Institucion</i></p> |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se institucioni garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për</i></p> |






| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>realizimin e procesit mësues-kërkimor, mbarëvajtjen në MP në "Menaxhim në Turizëm, Mikëpritje dhe Aktivitete Çlodhëse".</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |



V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| | |
|---|---|
| Standardi V.1 | |
| Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | <p>Programi i studimit Master Profesional në "Menaxhim në Turizëm, Mikëpritje dhe Aktivitete Çlodhëse" zhvillohet në përputhje me rregulloren e vet përkatëse, në rregulloren e UniBa, si dhe në Ligjin e Arsimit të Lartë. Në rregulloren e DMTRE përcaktohen qartë të gjitha njësitë, rolet dhe përgjegjësit e përkatëse për mbarëvajtjen e plotë të programit. Kjo rregullore i bashkangjitet dokumentave të tjera të UniBa dhe i shërben edhe studentëve të këtij program studimi për t'u bërë me dije për të drejtat dhe detyrimet e tyre përgjat gjithë kohës së studimit pranë këtij institucioni, (<i>neni 2, efekti juridik</i>).</p> <p>Në <i>nenin 4</i> të rregullores së UniBa, shkruhet se, studenti është një ndër 5 shtyllat e aktiviteteve kryesore. Shtylla, studenti në qendër përfshin organizimin dhe bashkëpunimin e njësive të angazhuara në proceset që zhvillohen në mbeshtetje të studenteve. Kjo fillon që nga njohja e tyre me UniBa deri tek pranimi, regjistrimi, angazhimi në jetën studentore dhe komunitare, mbështetja në përparimin profesional, dhe në karriere, etj. Nga dokumentacioni dëshmohet ekzistenca dhe funksionimi strukturave të dedikuara si; Zv. Rektori për çështjet</p> |

| | |
|--|---|
| | <p>studentore i cili menaxhon zyrat e:</p> <p>Zyra e Rekrutimit, Pranimi dhe Regjistrimit;</p> <p>Dekani i Studenteve dhe vet organizimin studentor;</p> <p>Zyra e Alumnit dhe Karrierës;</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh konkretisht me këto struktura dhe funksionimin e tyre, të cilat informonin studentët nga hyrja në programin e studimit e deri në përfundim të ciklit të studimit MP.</p> <p><i>RVB; Evidenca 1.1; Evidenca 1.2; Evidenca 1.3;</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p> | <p>Referuar rregullores së institucionit, të programit të studimit dhe evidencave të tjera shoqërues strategjik dëshmojnë se një ndër parimet e funksionimit të UniBa lidhet me faktin se kriteret dhe procedurat në hyrje e deri në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për student të programit të studimit MP në “Menaxhim në Turizëm, Mikëpritje dhe Aktivitete Çlodhëse”.</p> <p><i>RVB; Evidenca 1.1; Evidenca 1.2; Evidenca 1.3;</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p> | <p>Institucioni dëshmon se harton dhe publikon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve. Ato janë lehtësisht të aksesueshme në faqen e internetit dhe bëhen me dije pran zyrës së pranimi dhe informimit të studentëve. Këto kriteret publikohen në dokumente të veçant sikurse bëhen me dije edhe në faqen zyrtare të UniBa. Kriteret e pranimi të studentëve propozohen nga departamentin DMTRE dhe miratohen me vendim senati.</p> <p>Në fillim të çdo viti akademik, shpërndarja e këtij informacioni kryhet me mjete dhe mënyra të ndryshme komunikimi si:</p> <p>broshurat, fletëpalosjet;</p> <p>publikimet në rrjetet sociale;</p> <p>ëeb-in zyrtar të UniBa;</p> <p>ambientet fizike të institucionit;</p> <p>mediave të ndryshme televizive;</p> <p><i>Evidenca 18, Evidenca19</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së</p> | <p>Krahas të dhënave që jepen në RVB-ën e programit të studimit dhe dokumentacionit shoqërues GVJ konfirmoi ekzistencën e</p> |



| | |
|--|---|
| studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | kritereve e procedurave edhe gjatë vizitës në institucion ku studentët dakortësojnë ekzistencën dhe aksesueshmërinë e të gjithë informacionit që lidhet me procedurën që nga pranimit dhe përzgjedhja e studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, informacione këto që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. <i>RVB; Evidenca 20.7</i> |
| Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | Institucioni informon publikun dhe të interesuarit rreth kritereve të përgjithshme dhe të veçanta nëpërmjet faqes zyrtare të institucionit, në sesioni “Pranimet” dhe në portalin U-Albania në sesionin “Kriteret e Pranimit”. Informacioni është i arritshëm për të gjithë. GVJ e konfirmoi këtë edhe duhe hyrë në faqen zyrtare të UniBA. <i>RVB; Vizita në Institucion</i> |
| Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. | Institucioni dëshmon se nuk aplikon kritere shtesë por zbaton aktet ligjore dhe nënligjore të MAS-it lidhur me përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. <i>RVB, Evidenca 20.7</i> |
| Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. | Institucioni dëshmon se nuk aplikon kritere shtesë por zbaton aktet ligjore dhe nënligjore të MAS-it lidhur me regjistrimin e studentëve nga trojet shqiptare. <i>RVB, Evidenca 20.7</i> |
| Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. | Institucioni në mbështetje të kritere specifikë të parashikuara në aktet normativ të brendshëm të cilët ofron bursa studimi dhe i bënë ato publike. Adiministratori krijon komisionin Ad-Hoc për shqyrtimin e aplikimeve dhe miratimi bëhet me vendim të Bordit të Adminisitrimit të UniBa. <i>RVB; Evidenca 1.1</i> |
| Konkluzione | <i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se institucioni harton, ndjek dhe</i> |

| | | | | |
|-------------------------------------|---|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit. Nuk harton kritere të veçanta por është në zbatim të akteve ligjore e nënligjore. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| Standardi V.2 | |
|--|--|
| Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | Në bazë të dokumentacionit të shqyruar GVJ konsatoi se që hyrje të studimeve e deri në diplomim, studentët informohen vazhdimisht mbi çështje të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e tyre të përditshme akademike, si; kriteret e pranimit, procedurat e regjistrimit dhe tarifat, transferimi i studimeve dhe mobilitetet, këshillimin e studentëve, të drejtat e përfaqësimit, veprimtari akademike, kulturore, njoftime, sikurse dhe kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. <i>RVB;</i> <i>Evidenca 3</i> |
| Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | Në UniBa studentët informohen në lidhje edhe me njohjen e kualifikimeve të tyre të mëparshme ose të kryera herët në kohë, sikurse pranohen edhe transferime të studentëve nga institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. E gjithë kjo procedur është e rregulluar me dokumentacion dhe parashikohet në rregulloren e transferimeve, rregulloren e programit të studimeve si dhe nga evidencat e Manual Rekrutimeve Aplikim Regjistrim Transferim. <i>Evidenca 18</i> <i>Evidenca 19</i> <i>Evidenca 19.1</i> |



| | |
|---|--|
| <p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p> | <p>Informimi i studentëve lidhur me kriteret e proceduarat e vlerësimit të dijeve realizohet në disa forma:</p> <p>Nëpërjet rregulloreve të programit të studimit;</p> <p>Nëpërmjet praktikës së informimit të studentëve të viti të parë të programit;</p> <p>Nëpërmjet syllabuseve lëndore që jepen nga personeli akademik në orën e parë të fillimit të çdo lënde;</p> <p>Nëpërmjet personelit akademik në fillim të çdo semestri;</p> <p>Rregullorja e programit të studimit dhe silabuset aksesohen on-line nga studentët. Gjithashtu, në lidhje me diplomimin eksiston një informacion i shprehur përmes <i>evidencës 2.2</i> sipas së cilës, prova finale (mbrojta e temës së diplomës) është hapi përfundimtar i vlerësimit të dijes.</p> <p>GVJ konstaton se informimi i studentëve lidhur me proceduarat e vlerësimit është i larmishëm dhe i shtrirë në disa plane. Kjo u konfirmua edhe gjatë takimit me student në ditët e vizistës në institucion.</p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p> | <p>Institucioni UniBa ka hartuar një dhëzues në formën e rregullores “Udhëzime për proceduarat e përgatitjes dhe të mbrojtjes së provës finale për diplomën e studimeve master”. Studentët njihen me këtë dokument në fillim të semestrit të dytë nga koordinatori i studimeve master të UniBA.</p> <p>Në <i>rubrikën 2.4</i> “Përgjegjësit e Studentit” të këtij dokumenti, pika a. shprehet “Studenti duhet të jetë i familjarizuar me rregullat e procedurave të provës finale”</p> <p>Gjatë takimit me studentët GVJ konfirmoi se instiucioni nëpërmjet strukturave përkatëse kryente informimin për proceduarat e punimit të diplomës dhe diplomimit. <i>Evidenca 2.2</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e</p> | <p>Mbështetur në strategjinë e marketingut dhe të rekrutimit UniBa planifikon dhe zbaton kalendarin vjetor të aktiviteteve të cilat kanë si qëllim rekrutimin e studentëve të rinj në programet e studimit që ofrohen. Disa prej natyrës së aktiviteteve janë:</p> <p>Konferencë me mësuesit në karrirë të gjimnazeve dhe jo vetëm;</p> <p>Konferencë me maturantët;</p> <p>Vizitat e stafit në institucionet arimore të arsimit</p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| studimit. | parauniversitar; Ekskursion të maturantëve në mjediset e UniBa; Në çdo fillim të vitit akademik UniBa zhvillon “Javën e orientimit” për të interesuarit dhe studentët e ardhshëm. <i>Evidenca 29;</i> <i>Evidenca 29.1</i> | | | |
| Konkluzione | <i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se institucioni vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në MP në “Menaxhim në Turizëm, Mikëpritje dhe Aktivitete Çlodhëse”.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përbushet plotësisht | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| Standardi V.3 | |
|---|---|
| Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. | <p>Ngritja e strukturës Dekani i Studentit është një qasje mbështetëse dhe pozitive për studentin dhe për ta përfshire jo vetem ne qasjet sociale te institucionit por edhe për informimin e tyre rreth kohëzgjatjes e organizimit të programit të studimit.</p> <p>Përveç kësaj sturukture, institucioni për informimin e studentëve ka edhe një sistem të rëndësishëm. Portali SHLUJ i cili është i konsideruar nga studentët si mundësi për të aksesuar përmes kredencialeve private të tyre informacione mbi lëndët, kreditet, syllabuset etj. Ndërkohë që platforma google classroom përdoret për të hedhur leksione dhe materiale të ndryshme që i takojnë zhvillimit të leksioneve dhe seminareve. Kjo formë ka rezultuar efëçente që prej kohës së COVID-19 dhe përdoret ende nga personeli akademik dhe studentët si sistem i mirë dhe efektiv komunikimi.</p> |


| | |
|--|---|
| | <p><i>RVB</i></p> <p><i>Evidenca 37</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p> | <p>UniBa dëshmon se vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion për lëndët, modulet dhe veprimtaritë formuese. GVJ e konfirmoi këtë edhe në takimin e zhvilluar në institucion me studentët e programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 2;</i></p> <p><i>Evidenca 2.2;</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p> | <p>Dokumentacioni shoqërues dëshmon se nga marrveshjet e bashkëpunimit që UniBa ka me institucione publike dhe sipërmarrje private studentët mund të përfitojnë mëbështetje për punësim dhe zhvillim karriere në fushën e turizmit. Në takimin me studentët, GVJ u njoh me disa nga rastet kur studentët ishin njohur me ofrat e bëra lidhur me mundësin për punë në disa prej tyre.</p> <p><i>RVB</i></p> <p><i>Evidenca 10.2</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p> | <p>Gjatë vizitës në institucion, në takimin me studentët edhe përfaqësuesit e Qendrës së Karrierës dhe Alumni, GVJ u njoh me format e informimit:</p> <p>Sistemi i menaxhimit të brendëshëm;</p> <p>Veprimtari informuese që organizon vetë departamenti;</p> <p>Informim nga personeli akademik;</p> <p>Informim nga strukturat administrative në Rektorat;</p> <p>Informacioni i marrë në faqen zyrtare të internetit;</p> <p>Informacioni vihet në dispozicion të një publiku më të gjerë me anë të njoftimeve të zyrave të informimit apo Karrierës dhe Alumni në ëbsite-in zyrtar të UniBa për studentët e universitetit</p> <p><i>Evidenca 11.2</i></p> <p><i>Evidenca 11.3</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes</p> | <p>Të gjitha format e renditura në kriterin 4 të këtij standarti u japin mundësi të barabartë të gjithë studentëve për të qenë të informuar. Studentet mund të përdorin edhe kredencialet e tyre</p> |

| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | individuale të umb.edu.al përmes portalit studentor studentportal.barleti. | | | |
| Konkluzione | <i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit në MP në "Menaxhim në Turizëm, Mikëpritje dhe Aktivitete Çlodhëse.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |



| | |
|---|--|
| Standardi V.4 | |
| Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. | Mbështetur në dokumentacionin shoqërues institucioni UniBa dëshmon se mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarëve, në programin e studimit MP në "Menaxhim Turizëm, Mikëpritje dhe Aktivitete Çlodhëse". GVJ e konfirmoi këtë edhe në takimin me sekretarinë mësimore. <i>RVB;</i> <i>Evidenca 30, tabela 21</i> <i>Vizita në institucion</i> |
| Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet | Institucioni UniBa dëshmon se mban statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, në programin e studimit MP në "Menaxhim Turizëm, Mikëpritje dhe Aktivitete Çlodhëse". Për këtë program studimi nuk ka largime apo mospërfundim me sukses. Per vitin akademik - 2021-2022: 4 studentë |

| | |
|--|--|
| <p>para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p> | <p>Per vitin akademik - 2022 2023: 4 studentë</p> <p>Në takimin me sekretarinë mësimore, GVJ konfirmom mbajtjen e statistikave për studentët nga regjistrimi deri në diplomim.</p> <p><i>RVB;</i></p> <p><i>Evidenca 30, tabela 21</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p> | <p>Institucioni ka një system të brendshëm elektronik të menaxhimit të të dhënave. Ai është portali studentor i cili përdoret jo vetëm nga studentët por edhe nga sekretaria mësimore që në çdo kohë ka akses për të hedhur notat dhe rezultatet e provimeve, datat përkatëse të zvillimit të provimeve dhe kalendarin e provimeve, etj. Ndërkohë që ky portal shërben si burim rekord informimi për studentët për vlerësimet e tyre akademike.</p> <p><i>RVB;</i></p> <p><i>Evidenca 20.5</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njërive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p> | <p>Institucioni ka ndërtuar tabela të përfshira në aneksin e tabelave me informacione në lidhje me cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, ku reflektohet jo vetëm nr i studentëve të regjistruar për cdo vit akademik që nga 2021-2022 si vit i parë i lançimit të këtij program, por edhe mesataret përkatëse të studentëve, numrin e të diplomuarve sipas profilit të zgjedhur.</p> <p>Ndërkohë që edhe vetë departamenti e përfshin këtë çështje të raporteve analitike të studentëve në raportimet vjetore të tyre, ndërsa zyra e karrieres i mundëson dhe ofron përgjatë të gjithë kohës studentëve mundësi punësimi të ndryshme. Mbi bazën e këtij komunikimi që zhvillohet alumni më tej, përditësohet edhe Bordi i Karrierës pranë Departamentit DMTRE që është përgjegjës për këtë program studimi.</p> |
| <p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e</p> | <p>Referuar dokumenteve të konsultuar dhe në veçanti nga takimet me drejtuesin e njësis bazë që ofron këtë program studimi dhe me studentët e programit konfirmohet fakti që të gjithë studentët e të dy viteve akademike në MP janë të punësuar. Kjo tregon se program i studimit është i realizuar më së miri dhe se DMTRE si njësi ofruese ka realizuar misionin e tij si urë ndërlidhëse me tregun e punës. Gjatë kohës që studentët kanë zhvilluar studimet</p> |




| | | | | |
|---|--|-------------------------------------|------------------------------------|---|
| <p>duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p> | <p>kanë hapur edhe start-up-et e tyre, sikurse edhe kurset e tjera që ofron ky departament mbështesin edhe profilizimet dhe specializimet e tyre. Kështu, kualifikimet dhe trainimet afatshkurtra 1 dhe 4 mujore që ofrohen jo vetëm studenteve por edhe të gjithë të interesuarve që duan të punojnë (udhërrefyesi turistik 4 mujore, trajnimet në agjensi dhe operatorë turistike, shërbime në industrinë mikpritëse) janë në mbështetje të plotë të formimit cilësor dhe sasior të studentëve duke diversifikuar në këtë mënyrë ofertën që ky departament zhvillon në funksion të transferimit të dijeve.</p> <p><i>RVB</i> <i>Evidenca 21.4</i> <i>Vizita në institucion</i></p> | | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se institucioni mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre në MP në "Menaxhim në Turizëm, Mikëpritje dhe Aktivitete Çlodhëse".</i></p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Në përmbushje</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |

| | |
|---|--|
| <p>Standardi V.5</p> | |
| <p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore</p> | <p>Referuar RVB, studentët janë të përfshirë në forma të ndryshme në programin e studimit. Përveç pasjes së një Dekani posaçërisht për ta, u mundësohet midis të tjerave edhe një jetë sociale në komunitet e më gjerë.</p> <p><i>RVB</i> <i>Vizita në institucion</i></p> |

| | |
|--|---|
| të vetë institucionit. | |
| Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | <p>Institucioni garanton përfshirjen e studentëve nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në senat, këshillin e etikës dhe shanseve të barabarta, njësinë e sigurimit të brendëshëm dhe cilësisë, këshilin /qeverinë e nxënësve. Një herë në muaj studentët mund të marrin pjesë në mbledhjet e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit. GVJ e konfirmon këtë edhe në takim e zhvilluar në institucion me student e këtij program studimi.</p> <p><i>RVB</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p> |
| Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj. | <p>NjZHKC që funksionon pranë këtij institucioni përfshin studentët në zhvillimin e pyetësorit dy javë përpara përfundimit të çdo semestri për vlerësimin e programit të studimit MP në “Menaxhim në Turizëm, Mikëpritje dhe Aktivitete Çlodhëse”, në lidhje me përmbajtjen dhe zhvillimin e moduleve, performancën e personelit akademik në mëimdhënie, vlerësim dhe punën shkencore. Shpesh herë studentët bëhen pjesë e focus grup për çështje që lidhen me veprimtaritë mësimore dhe praktike të programit që zhvillojnë.</p> <p><i>RVB;</i></p> <p><i>Evidenca 11.2.1</i></p> <p><i>Evidenca 11.2.2</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p> |
| Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | <p>Mënyra e kontrollit dhe e vlerësimit të dijeve është pjesë përbërse e syllabusit në çdo lëndë dhe ofron shpërndarjen e pikëve dhe të përqindjeve të vlerësimit sipas rubrikave përkatëse. Që në fillim studenti e di se testimi final është 50% e vlerësimit, frekuentimi është 10%, detyra e kursit 20% dhe testet gjatë vitit janë 20%. Këto forma të vlerësimit të njohurive u rekomanduan të jenë standarte dhe të mos lëvizin nga syllabusi ne syllabus, pasi instiucioni e ka të standartizuar këtë format kontrolli në dokumentacionin e vënë në dispozicion.</p> <p>Nga takimi me studentët gjatë vizitës në institucion GVJ gjykoj se një shtim i orëve të praktikës do të përmironte më shumë lidhjen me tregun ne bankat e shkollës si dhe nevojë për lëndët me zgjedhje. GVJ në takimin që zhvilloi me grupin e studentëve gjatë vizitës në institucion u qartësua se rradha e ndjekjes së</p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <p>procedurave përkatëse për problematika është:</p> <p>-Studentët fillimisht i përcjellin senatorëve të tyre shqetësimin apo informacionin;</p> <p>-Senatorja ia përcjell drejtuesit të njësisë bazë dhe më tej dekanit të studentëve;</p> <p><i>RVB</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p> | | | |
| Konkluzione | <p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se institucioni përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre në MP në "Menaxhim në Turizëm, Mikëpritje dhe Aktivitete Çlodhëse.</i></p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Plotësisht | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | |
|--|---|
| Standardi V.6 | |
| <p>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</p> | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p> | <p>Nga shqyrtimi i RVB-së dhe takimi me stafin akademik rezulton se institucioni organizon në fillim të vitit akademik "Javën e orientimit". Gjatë kësaj jave personeli akademik i departamentit të DMTRE i njuh studentët me programin. Përgjatë javëve të regjistrimit, institucioni vendos grupe të personeli akademik për të informuar studentët e interesuar. Gjithashtu mbledhjet e departamentit janë të hapura për studentët e interesuar. Përgjatë javëve të regjistrimit, institucioni vendos grupe me personel akademik, për të informuar studentët e interesuar. Por pavarësisht kësaj, UniBa i ka të ngritura grupet që merren me studentët që në momentin e pranimit e deri në daljen e tyre në punë, e kthimin e tyre në alumni. Ato fillojnë me Zyrën e pranimit të studentëve, Sekretaria mësimore, Dekani i</p> |

| | |
|---|--|
| | <p>Studentëve, Zyra Alumni dhe e Karrierës, Departamenti (përmes kordinatorit, stafit dhe drejtuesit të tij).</p> <p><i>RVB</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p> | <p>DTMRE ka në stukurë një koordinator për çështjet e mbarëvajtjes së procesit mësimor dhe programin e studimit i cili ka për funksion informimin, ndjekjen dhe përparimin e studentëve. Gjithashtu ai i asiston studentët për çështje që lidhen me procesin mësimor. Përveç kordinatorit, studentët asistohen edhe nga Dekani i studentëve.</p> <p><i>RVB</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p> | <p>Rolin e njësisë për këshillimin e karrierës e luan Qendra e Karrierës dhe Alumni e cila zhvillon veprimtarinë e saj mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin dhe Rregulloren e përgjithshme të UniBa. Gjatë vizitës me përfaqësues të kësaj njësie dhe në takimin me studentët e programit mësuam për orientimin që kjo njësi u jep studentëve për realizimin e praktikave profesionale apo informime në lidhje me mundësitë e punësimit të tyre. Ndërkohë që po brenda UniBa është ngritur edhe Klubi i Karrierës i cili përbën ndër klubet studentore që organizon studentët dhe zhvillon me to aktivitete lidhur me zhvillimin e tyre të karrierës. Synimi i këtij klubi është zhvillimi dhe përmirësimi i aftësive individuale dhe profesionale të tyre, për të rritur konkurrueshmërinë e tyre në tregun e punës.</p> <p><i>RVB</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese</p> | <p>Zyra e Karrierës dhe Alumni është zyra e fundit që ndjek studentët në diplomimin dhe punësimin e tyre, si dhe kthimin e studentëve në alumni efficient dhe mbështetës për këtë program studimi në veçanti, por edhe institucionin në përgjithësi. Në këtë mënyrë Bordi i Karrierës mbahet efficient dhe mbështet programin.</p> <p><i>RVB</i></p> |


| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| përkatëse. | | | | |
| Konkluzione | <i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët në MP në “Menaxhim në Turizëm, Mikëpritje dhe Aktivitete Çlodhëse”.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | | | | |
|---|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT



| | |
|--|--|
| Standardi VI.1 | |
| Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | Dokumentacioni shoqërues dëshmon se institucioni ka hartuar udhëzues për mësimdhënien dhe të nxënit në shkollat e larta. Në këtë dokument trajtohen çështje si: <ol style="list-style-type: none"> 1. Veçoritë të mësimdhënies dhe të nxënit në arsimin e lartë; 2. Metoda të mësimdhënies; 3. Formate programesh, instrumente vlerësimi dhe vetëvlerësimi; <i>RVB;</i> <i>Evidenca 11</i> |
| Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë | UniBa nëpërmjet NJZHKC dhe Zv. Rektori për çështjet mësimore të cilët janë edhe strukturat përgjegjëse për |

| | |
|---|---|
| <p>mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p> | <p>mbarëvajtjen e procesit mësimor vlerësojnë në mënyrë periodike mësimdhënien, aplikimin e të rejave në metodat e mësimdhënies si nga ana e personelit akademik ashtu edhe për personelin ndihmësakademik. Mekanizmat e monitorit janë nëpërmjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimi që studentët bëjnë në përfundim të çdo semestri lidhur me performancën e personelit akademik në mësimdhënies; 2. Vlerësimi peer to peer midis kolegëve lidhur me cilësinë e mësimdhënies; 3. Nëpërmjet analizave dhe rrahjes së mendimeve në njësinë bazë; <p><i>RVB</i> <i>Evidenca 11.1</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p> | <p>Të dhënat e paraqitura nga UniBa tregojnë që përfshirja e studentëve në vlerësimin e formave të mësimdhënies kryhet në mënyrë periodike e në mënyrë të vazhdueshme. Nga takimi që GVJ pati me studentët u confirmua që ky process kryhej në vazhdimësi dhe me seriozitet. Ata dëshmuuan se nuk kanë patur raste ankimimesh dhe se diponibiliteti i strukturave përgjegjëse nuk i'u mungonte.</p> <p><i>RVB</i> <i>Evidenca 11.2.2</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p> | <p>NJZHKC si struktura përgjegjëse për monitorim dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie i bënë publike gjetjet në disa forma si; përcjelljen e gjetjeve në njësinë kryesore e më pas në njësinë bazë dhe në fund personelit akademik, publikon gjetjet në faqen zyrtare të UniBA. GVJ përdori linkun e vënë në dispozicion në RVB dhe konfirmoi hedhjen e tyre në faqen e institucionit.</p> <p><i>RVB</i> <i>Vizita në Institucion</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të</p> | <p>Nga RVB-ën dhe nga dokumtacionet shoqëruese nuk rezulton që shembujt e praktikave më të mira të promovohen nga institucioni për të nxitur rritjen e cilësisë së mësimdhënies në të ardhmen. Për këtë, <i>GVJ rekomandon që gjetjet për mësimdhënësin më të mirë të proklamohen në mënyrë që të shërbejnë si stimuj për personelin akademik më të rinj në këtë profesion.</i></p> |





| mësimdhënies. | | | | | | | | | |
|--|--|----------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|--|---|
| Konkluzione | <i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se institucioni ndjek një politikë të qartë për dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit por duhet të bëjë më shumë për të promovojë shembuj të praktikave më të mira. në MP në “Menaxhim në Turizëm, Mikëpritje dhe Aktivitete Çlodhëse”.</i> | | | | | | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | <table border="1"> <tr> <th>Nganjëzues</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table> | Nganjëzues | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | X |
| Nganjëzues | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | | |
| | | | X | | | | | | |

| Standardi VI.2 | |
|---|--|
| Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | <p>Bazuar në Statutin dhe Rregulloren e UniBa janë të përcaktuara strukturat dhe procedurat për realizimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Struktura që realizon këtë proces në nivel institucional është Njësia e Zhvillimit të Kurikulës dhe Cilësisë (NJZHKC), Komisioni i Sigurimit të Standarteve dhe Cilësisë. Standardet për sigurimin e cilësisë në UniBa janë në përputhje me Kodin e Cilësisë, hartuar nga ASCAL dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve. Në startegjinë e zhvillimit të UniBa 2020-2030 janë përcaktuar objektiva të qartë dhe të matëshëm lidhur me cilësinë e procese akademike.</p> <p><i>Evidenca 1.3</i> <i>Evidenca 17;</i> <i>Evidenca 17.1;</i> <i>Evidenca 12</i></p> |
| Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për | <p>UniBa ka Njësinë e Zhvillimit të Kurikulës dhe Cilësisë (NJZHKC) e cila ka për detyrë vlerësimin periodik të veprimtarisë mësimore e kërkimore. NJZHKC ka akses në të gjitha të dhënat e UniBa. Ai realizon politikat, strategjitë dhe proceset për të garantuar cilësinë në UniBA. Gjithashtu komisioni i sigurimit të cilësisë jep sygjerime dhe rekomandone</p> |


| | |
|--|---|
| <p>përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p> | <p>në funksion të përmirësimit të cilësisë në institucion.</p> <p><i>RVB;</i></p> <p><i>Evidenca 1.3</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p> | <p>UniBa përdor strukturat brenda tij për realizimin e sigurimit të cilësisë. Instrumenti që përdor UniBa për sigurimin e cilësisë është “Manuali i Cilësisë” i cili specifikon parimet dhe procedurat e sigurimit të cilësisë në institucion në përputhje me kodin e cilësisë. Institucioni i është nënshtruar akreditimit institucional dhe akreditimit të programeve të studimit në mënyrë të vazhdueshme. <i>RVB</i></p> <p>NJZHKC administron, organizon dhe përgatit vizita të vlerësimit të jashtëm duke ftuar ekspertë të jashtëm për të trajnuar stafin që merret me vlerësimin e brendshëm. Në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë janë të përfshirë si bashkëpunëtorë të jashtëm studentët e diplomuar dhe punëdhënësit. <i>RVB</i></p> <p>Në takimin me përfaqësues të NJZHBC në UniBa dhe takimin me GVB, konkretisht, studentin që ishte pjesë e grupit të punës, u theksua realizimi dhe pjesëmarrja e aktorëve të jashtëm në funksion të përmirësimit të cilësisë.</p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p> | <p>Nga RVB institucioni dëshmon se si tregues të matshëm për mësimdhënie dhe kërkim-shkencor përdor vetëdeklarimin që personeli akademik bënë në përfundim të çdo sismestri dhe nëpërmjet vlerësimit që drejtuesi i njësisë bazë i bënë punës së çdo personeli akademik, anëtar i njësisë e cila është një procedurë e standartizuar në institucionet e arsimit të lartë në vend.</p> <p>Duke mbajtur në konsiderat që kjo form është vetëdeklaruese dhe nuk përmban tregues të detajuar për vlerësimin e procesit mësimor <i>GVJ sygjeron hartimin e një fishe vlerësuese me tregues konkret të pikëzuar sipas rëndësisë dhe peshës që ato duhet të kenë për këtë vlerësim. Kjo mënyrë do të mundësojë evidentimin e praktikave më të mira në mësimdhënie nga personeli akademik dhe promovimin e personelit akademik me arritje në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.</i></p> |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se institucioni ka politika dhe procedura transparente në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të</i></p> |




| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>sigurimit të cilësisë në MP në "Menaxhim në Turizëm, Mikëpritje dhe Aktivitete Çlodhëse", por duhet të përcaktojë tregues te veçantë të pikëzuar në varësi të programit të studimit për të bërë vlerëim sa më objektiv dhe të promovojë arritjet më të mira.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet plotësisht | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X | |

| Standardi VI.3 | |
|---|--|
| Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p> | <p>Në nivel institucional struktura përgjegjëse për monitorimin e cilësisë, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programit të studimit është sektori i kurrikulës, vlerësimi institucional dhe alumni që janë ngritur brenda NJZHKC-së dhe Zv. Rektori për çështjet akademike. Në nivel njësie bazë, është Departamenti që ka programin e studimit, i cili së bashku me strukturat e tij të brendshme si koordinatorët e programeve dhe përgjegjësit e grup-lëndëve është përgjegjës për sigurimin e cilësisë. UniBa përmes NJZHKC-së realizon raporte vlerësimi periodike vjetore mbi elementë të ndryshëm të programeve të studimit në nivel Universiteti. Përmbajtja e këtyre raporte trajtohet në disa nivele brenda institucionit. NJZHKC nëpërmjet kontrolleve të vazhdueshme të procesit mësimor, zbulon problematika të lidhura me përmbajtjen e kurrikulës dhe i referon ato departamentit për rishqyrtim. Në kuadër të objektivave të saj, NJZHKC siguron bazën e të dhënave për cilësinë e mësimdhënies. Në bashkëpunim me drejtuesin e njësisë bazë, NJZHKC mbikëqyr efikasitetin e kurrikulave, pasqyrimin e tyre me korrektësi në programet lëndore, në formatin e vlerësimit të miratuar, dhe në literaturën e vënë në dispozicion të studentëve.</p> <p>Raportet e realizuara nga NJZHKC-ja janë në dispozicion të strukturave drejtuese dhe stafit. Trajtimi i rezultateve të tyre në institucion bëhet në nivel Rektorati ku Zv. Rektori për çështjet akademike organizon dhe mbikëqyr punën e fakulteteve dhe</p> |



| | |
|--|--|
| | <p>programeve me qëllim rritjen e standarteve të cilësisë, në programet e studimit të ofruara nga UniBa dhe mësimdhënies nga ana e personelit akademik.</p> <p><i>RVB</i></p> <p><i>Evidenca 17</i></p> <p><i>Evidenca 17.1</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p> | <p>Bazuar në RVB-në, monitorimi i procesit të përmbushjes së masave në kuadër të mangësive të konstatuara realizohet nga NJZHKC-ja nëpërmjet monitorimeve të vazhdueshme nga personat përgjegjës, autoritetet drejtuese, nga diskutimet me stafin akademik si dhe pyetësorëve.</p> <p>Në raportet e hartuara evidentohen dhe raportohen çështje si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Cilësia e materialeve mësimore (literaturës); ✓ Cilësia e performancës së personelit akademik; ✓ Komunikimi pedagog-student; ✓ Konceptimi i transparencës në vlerësim; ✓ Përputhja e materialit lëndor me format dhe mënyrat e vlerësimit; ✓ Raporti teori/ praktikë në kurrikula, etj; <p>Mangësitë ju bëhen me dije personelit akademik të departamentit të MTRE dhe në mbledhjet e organizuara në këtë njësi ato bëhen objekt i analizës vjetore. Një tjetër formë është edhe sistemi i raportimit të personelit akademik në fund të çdo jave për ecurinë e procesit mësimor dhe lënë të dokumentuar komentet përkatëse lidhur me mangësitë e konstatuara. Nga takimi që GVJ pati me personelin akademik të njësisë konfirmoi jo vetëm realizimin e analizës rreth gjetjeve por edhe u njoh më konkretisht me disa prej masave që personeli akademik kishte marrë për përmirësimin e tyre siç ishte, shmangja e njohurive paralele në lëndë të përafërta, përmirësimin e formave të vlerësimit, ose shtimin e numrit të lëndëve me zgjedhje/ me karakter më praktik.</p> <p><i>RVB;</i></p> <p><i>Vizita në Institucion;</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e</p> | <p>Dokumentacioni shoqërues dëshmon se institucioni përdor instrumente vlerësues të drejtpërdrejt për didaktikën, kurrikulën,</p> |




| | |
|---|--|
| <p>cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p> | <p>të mësuarit dhe provimeve. Disa prej tyre janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Vet-raportim i personelit akademik për punën simestrale; ➤ Mbledhje periodike e njësisë bazë që ka përgjegjësinë për programin dhe ka për object ecurinë e procesit mësimor; ➤ Vlerëim paraprak i tezës së provimit nga drejtuesi i njësisë bazë; ➤ Raporti vjetor i njësisë bazë ku analizohen arritjet dhe mangësit e procesit mësimor; <p><i>Në të ardhmen <u>GVJ sygjeron</u> që të kryhen vlersime të notës mesatare, kalueshmërisë dhe frekuentimit për çdo lëndë, të analizohet lidhja midis këtyre komponentëve të rëndësishëm në mësimdhënie. Gjetjet të jenë pjesë e analizave në njësinë bazë dhe të raportohen në analizën vjetore.</i></p> <p><i>RVB;</i></p> <p><i>Evidenca 21.4</i></p> <p><i>Evidenca 41</i></p> <p><i>Evidenca 11.1</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të</p> | <p>Dokumentacioni shoqërues dëshmon se institucioni përdor instrumente vlerësues të drejtpërdrejt për didaktikën, kurrikulën, të mësuarit dhe provimeve. Disa prej tyre janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Formular vlerësimi i studentëve për lëndën; ➤ Formular vlerësimi të mësimdhënies kolegë me kolegë; <p>Informacioni i synuar lidhet me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Organizimin e lëndës; - Programin e lëndës; - Materialet e lëndës; - Komponentët e vlerësimit; - Pedagogu; - Materialet e mësimdhënies; - Performanca e klasës; - Vëzhgime; <p>GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi realizimin e tyre si nga</p> |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| përftuara nga ky program. | studentët ashtu edhe nga takimi me personelin akademik që shërben në programin e studimit. <i>Evidenca 11</i> <i>Evidenca 11.1</i> <i>Evidenca 11.2</i> <i>Vizita në institucion</i> | | | |
| Konkluzione | <i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se IAL monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëniet në “Menaxhim në Turizëm, Mikëpritje dhe Aktivitete Çlodhëse”.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |


| Standardi VI.4 | |
|--|--|
| Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | Sipas Rregullores së UniBa, standardet dhe cilësia, përfshijnë disa struktura si: <ul style="list-style-type: none"> a. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore-shkencore, të UNIKON-it. Mënyra e ngritjes dhe funksionimit të tij rregullohet me dokument të veçantë; b. Komisioni Për Vlerësimin e Standarteve dhe Cilësisë; c. Zv. Rektor për veprimtarinë akademike; d. Njësia përgjegjëse DTMR për programin e studimit; e. Grupet ad hoc të vlerësimit të brendshëm; f. Zyra e Burimeve Njerëzore; UniBa realizon politika dhe procedura të brendshme të cilësisë |





| | |
|--|--|
| | <p>duke përfshirë disa aktorë në proces si: bordet e tregut të punës; ekspert të jashtëm; përfshirja në projekte ndërkombëtare me fokus sigurimin e cilësisë së brendshme si Erasmus +. Përfshirja në këto projekte ka krijuar shkëmbime përvojash, trajnime, vizita studimore si dhe procese të tjera që lidhen me monitorimin dhe vlerësimin e funksionit e sigurimit të cilësisë së brendshëm.</p> <p><i>RVB;</i> <i>Evidenca 2;</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p> | <p>Përgjegjësitë dhe detyrat e njësive të angazhuara janë të përcaktuara në kuadrin ligjor si Rregullore e UniBa, rregullore e FSHTS, rregullore e DTMR, mbi të cilin funksionon UniBAa dhe njësitë përbërse të tij. Mbështetur në dokumentacionin mbështetës GVJ i rezulton se ekzistojnë urdhëra të rektorit dhe vendime të drejtuesit të njësisë bazë për detyra konkrete që njësitë dhe individët angazhohen në organizimin dhe menaxhimin e veprimtarisë kërkimore shkencore dhe koordinimin e saj sektorin e projekteve, kërkimit shkencor dhe të botimeve në UniBa.</p> <p><i>RVB</i> <i>Evidenca 2</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p> | <p>NJZHKC-ja nuk realizon raporte në nivel program studimi. Gjatë procesit të realizimit të pyetësorit ajo përfshin në sondazhet për vlerësim të gjithë personelin akademik, studentët e Departamentit dhe personelin ndihmës akademik.</p> <p>Gjithashtu, siguri i cilësisë së programit bëhet objekt analize çdo fund viti akademik nga vetë njëzia bazë që e ofron programin e studimit, nga departamenti.</p> |
| <p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit</p> | <p>UniBa ka disa standarde të cilat i respekton për përzgjedhjen e anëtarëve në procesin e vlerësimit-NJSBC-së dhe KVSC-së (si: kompetenca profesionale, paanshmëria, përfaqësimi për çdo njësi, rotacioni ...etj).</p> <p>Bazuar në <i>RVB fq.64</i> përfshirja e aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit të brendshëm kryet në përputhje me Kodin e Etikës dhe përpiqet të shmangë çdo lloj diskriminimi apo</p> |



| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| dhe studentëve. | pabarazie kundrejt personelit dhe të drejtave të studentëve. | | | |
| Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | Nga RVB nuk është shumë e qartë nëse ka bashkëpunëtorë apo ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit dhe që marrin pjesë në vlerësimin e brendshëm të cilësisë. <i>Gjithashtu GVJ konstaton mungesë të dokumentacionit mbështetës lidhur me rolin që ekspertiza e jashtme duhet të japë në vlerësimin e cilësisë për programin e studimit.</i> | | | |
| Konkluzione | <i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se përfshihen njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre, por nuk qartësohet ekzistenca e bashkëpunëtorëve të jashtëm që marrin pjesë në vlerësim në "Menaxhim në Turizëm, Mikëpritje dhe Aktivitete Çlodhëse". GVJ shpreh vlerësimin: Përmbushet kryesisht.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Asnjë përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X | |

| | |
|---|---|
| Standardi VI.5 | |
| Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë | Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë vepron në bazë të një plani veprimi vjetor të miratuar nga Rektori i Institucionit UniBA. Rregullorja e NJZHKC-së është dokumenti në të cilin përcaktohen rregullat e organizimit të veprimtarisë në kuadër të sistemit të brendshëm të cilësisë. Këto dokumenta sikundër pranohet në RVB dhe "...raportet e NJZHKC-së përmbajnë të |



78


| | |
|---|--|
| <p>transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p> | <p>dhëna sensitive dhe personale, ato bëhen pjesë e diskutimeve në ato grupe për të cilat raporti ka ndikim të drejtpërdrejtë” <i>Evidenca 17.1;</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> | <p>Vlerësimi kryhet në nivel institucional, dhe rezultatet e tij iu bëhen me dije strukturave drejtuese. Struktura drejtuese i përcjell rezultatet në njësinë bazë dhe ato elementë që lidhen me këtë njësi. Në departament trajtohet me personelin akademik ato elementë të vlerësimit që lidhen ngushtë me veprimtarinë e tyre. Raportet e NJZHKC-së janë transparente dhe publikohen në seksionin e Sigurimit të Cilësisë në faqen e ëeb site-it të UniBAdhe në seksionin e Vlerësimit të Performancës. GVJ hyri në këto site dhe konfirmoi publikimin e tyre. <i>RVB</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p> | <p>Institucioni realizon në vijueshmëri procesin e përpilimit të rezultateve dhe masave që duhet të ndërmerren si rezultat i raportit. Sipas RVB-së disa nga masat e marra lidhen me aktivitete për ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve akademike përmes realizimit të seminareve të trajnimit me natyrë didaktike të mësimdhënies apo për kërkimin shkencor. <i>RVB;</i> <i>Evidenca 11.4</i> <i>Vizita në institucion</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p> | <p>Përpjekjet për të reflektuar gjetjet e raportit sikundër dhe monitorimin janë në nivel institucional. Përmes kontrollit të kryqëzuar, strukturat dhe aktorë të brendshëm të UniBa reflektojnë mbi rezultatet e raportit dhe realizojnë masa që lidhen me programet e studimit për ta përmirësuar më tej. <i>RVB;</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p> | <p>Realizimi i vlerësimit të përvitshëm nga ana e NJZHKC-së përmes planit të punës mundëson angazhimin e strukturave akademike dhe studentët në proces. Aksesin në dokumentat ku bazohet kjo veprimtari është e mundur si për stafin akademik, administrativ dhe studentët në nivel institucional. Gjatë vizitë në institucion GVJ u njoh nga personeli akademik dhe studentët që procesi i veprimtarive periodike me qëllim njohjen, ndërgjegjësimin dhe trainim është kryer edhe gjatë periudhës së pandemisë COVID 19 on-line. Duke kofirmuar edhe</p> |


| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | deklarimin në RVB të këtij argumenti. | | | |
| Konkluzione | <i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë në "Menaxhim në Turizëm, Mikëpritje dhe Aktivitete Çlodhëse".</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | | | | |
|--|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të Ciklit të Dytë në: Master Profesional në: "Menaxhim në turizëm, mikpritje dhe aktivitete çlodhëse" me profile: "Turizëm dhe udhëtime", "Mikpritje dhe hoteleri, restorant dhe katering", "Aktivitete çlodhëse dhe aktivitete në natyrë"

a. Pikat e forta:


1. Institucioni garanton kapacitetet infrastrukurore dhe njerezore për ofrimin e një programi cilësor, gjë e cila reflektohet në personelin akademik në rang të njësisë qendrore dhe asaj bazë ku ofrohet programi i studimit si dhe ambientet dhe infrastruktura që ofrohet për zhvillimin e mësimin;
2. Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, biznese vendase dhe / ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit;
3. Institucioni ndjek vijueshmërinë e punësimit të studentëve në përshtatje me kërkesat e tregut në industrinë e turizmit nëpërmjet strukturave dhe bashkëpunimeve të ngitura duke siguruar punësimin e tyre;




4. Institucioni nxit përfshirjen e studentëve, partnerëve dhe organizmave të tjera në hartimin, përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre, e cila reflektohet në marrëveshjet e bashkëpunimit si dhe ngritjen e Bordit të Karrierës së Turizmit, të përbërë nga ekspertë të fushës akademike, biznesit, etj;
5. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie, nëpërmjet metodave bashkëkohore, motivon dhe nxit studentët për studime konkrete që lidhen me lëndët që ato zhvillojnë në këtë program studimi, nëpërmjet rasteve studimore, detyrave të kursit, konkurseve, pjesëmarrje në panaire etj;
6. Institucioni reflekton pjesëmarrje të gjerë në projekte zhvillimore në bashkëpunim me organizata jo qeveritare në lëmin e turizmit duke përfshir personelin akademik dhe studentët në kërkimin shkencor dhe aplikimin e tij;
7. UniBa ka në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme në “Menaxhim në Turizëm, Mikëpritje dhe Aktivitete Çlodhëse”;
8. UniBA disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional efikas dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit në MP në “Menaxhim në Turizëm, Mikëpritje dhe Aktivitete Çlodhëse”;
9. UniBA zbaton procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët në MP në “Menaxhim në Turizëm, Mikëpritje dhe Aktivitete Çlodhëse”. Standarti V.5; Konkluzion;

b. Pikat e dobëta:

1. Problematika të hasura në sylabuset e lëndëve si: problemi i emërimit të lëndëve, të literaturës, të përmbajtjes së temave brenda sylabuseve; **Standarti II.3, Kriteri;**
2. Në planin mësimor vihet re: panevojshmëria e lëndëve të caktuara, si dhe riorganizimi i lëndëve sipas peshës specifike që kanë disiplinat; **(standartit II.3, Kriteri 5)**
3. Kurrikula e programit dominohet nga lëndë të karakterit bazë dhe jo praktik. Problemet e identifikuara i përkasin 3 kategorive:
 - ✓ Riklasifikim i moduleve sipas tipit të veprimtarisë;
 - ✓ Përfshirje të lëndëve bazë dhe ato të kategorive të tjera që lidhen direkt me formimin e studentëve për qellimin që ka dhe synon ky program studimi, kryesisht përfshirjen e lëndëve që janë të lidhur me turizmit, mikëpritjen dhe aktivitetet çlodhëse;
 - ✓ Zëvendësimin e lëndëve ekzistuese me lëndë të reja dhe inovative në fushën e industrisë së turizmit, mikëpritjes dhe aktiviteteve çlodhëse; **(standartit II.4, Kriteri 1, 2, 3)**




4. Mungesa e një studimi tregu pas daljes në treg të të diplomuarve, në funksion të rritjes së bashkëpunimit dhe fuqizimit të departamentit me industrinë, në funksion të përmirësimit të aftësive praktike të studentëve si dhe punësimit potencial të tyre; *(standartit I.3, Kriteri 4)*
5. Numri i ulët i stafit të specializuar në fushën e turizmit, për këtë sugjerohet mundësia e rekrutimit të stafit të brendshëm dhe të jashtëm me specialitet në fushën e turizmit; *(standartit III.1, Kriteri 4)*
6. NJZHKC-ja nuk realizon raporte në nivel të programit të studimit MP në “Menaxhim në Turizëm, Mikëpritje dhe Aktivitete Çlodhëse”. *(Standarti IV.4; Kriteri 3)*
7. Mungon dokumentacioni në lidhje me kontarta e punës dhe dokumente të tjera që lidhen me përmbushjen e detyrimeve për mbulimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. *(Standarti IV. 1; Kriteri 3)*



Rekomandime

1. GVJ rekomandon shtimin e titujve të librave në gjuhë të huaj të pesë viteve të fundit për programit të studimit MP në “Menaxhim në Turizëm, Mikëpritje dhe Aktivitete Çlodhëse”;
2. Hartimin e një fishe vlerësuese me tregues konkret të pikëzuar sipas rëndësisë dhe peshës që ato duhet të kenë për këtë vlerësim. Kjo mënyrë do të mundësojë evidentimin e praktikave më të mira në mësimdhënie nga personeli akademik dhe promovimin e personelit akademik me arritje në mësimdhënie dhe kërkim shkencor;
3. Të fuqizohet roli i ekspertizës së jashtme në vlerësimin e cilësisë për programin e studimit MTMAÇ;
4. Hartimi i një raport specifik financiar për programin e studimit në MP në “Menaxhim në Turizëm, Mikëpritje dhe Aktivitete Çlodhëse”. *(Standarti IV.5; Kriteri 4);*

Evaluation Results of the Second Cycle study program in: Professional Master in: "Management in Tourism, Hospitality and Leisure Activities" with profiles: "Tourism and Travel", "Hospitality and Hospitality, Restaurant and Catering", "Leisure Activities and outdoor activities"

a. Strengths:

1. The institution guarantees the infrastructural and human capacities for the provision of a quality program, which is reflected in the academic staff at the rank of the central unit and the base where the study program is offered, as well as the facilities and infrastructure provided for the development of learning;
2. The institution guarantees cooperative relations with local and/or foreign institutions, companies, businesses in order to realize the study program, within the framework of professional training, scientific research and mobility;

3. The institution follows the continuity of the employment of students in accordance with the market requirements in the tourism industry through established structures and collaborations, ensuring their employment;
4. The institution encourages the involvement of students, partners and other organizations in the design, continuous improvement of the study program and successful implementation in accordance with their objectives, which is reflected in the cooperation agreements as well as the establishment of the Tourism Career Board composed of experts in the academic field, business, etc.;
5. The academic staff engaged in teaching, through contemporary methods, motivates and encourages students for concrete studies related to the subjects they develop in this study program, through case studies, course assignments, competitions, participation in fairs, etc. Standard II.6, Criterion 2, 3, 4;
6. The institution reflects extensive participation in development projects in cooperation with non-governmental organizations in the field of tourism, involving academic staff and students in scientific research and its application;
7. The institution has at its disposal suitable learning environments and infrastructure for the realization of the teaching process of the study program and for practical training, especially in "Management in Tourism, Hospitality and Leisure Activities". Standard IV.2; Conclusion;
8. The institution has an efficient internal institutional management system and makes it available for administration, information and monitoring of academic, financial and administrative activity for the study program at the Ministry of Education in "Management in Tourism, Hospitality and Leisure Activities". Standard IV.4; Conclusion;
9. The institution implements procedures and special units for the reception, orientation, counseling of students, management of complaints and problems, which exercise their activity permanently and are easily accessible by students in the Ministry of Education in "Management in Tourism, Hospitality and Activities Relaxing". Standard V.5; Conclusion;


b. Weak points:

1. Problems encountered in the course syllabi, such as: the problem of naming the subjects, of the literature, of the content of the topics within the syllabus; (*Standard II.3, Criterion*)
2. In the curriculum it is noted: the unnecessariness of certain subjects, as well as the reorganization of subjects according to the specific weight of the disciplines; (*Standard II.3, Criterion 5*)
3. The curriculum of the program is dominated by subjects of a basic and non-practical nature. The identified problems belong to 3 categories:
 - Reclassification of modules according to the type of activity;
 - Inclusion of basic subjects and those of other categories that are directly related to the formation of students for the purpose that this study program has and aims for, mainly the inclusion of subjects that are related to tourism, hospitality and recreational activities;
 - Replacement of existing subjects with new and innovative subjects in the field of tourism industry, hospitality and leisure activities; (*Standard II.4, Criterion 1, 2, 3*)
4. The lack of a market study after the exit of the graduates to the market, in order to increase the cooperation and strengthening of the department with the industry, in order to improve the practical skills of the students as well as their potential employment; (*Standard I.3, Criterion 4*)

5. The low number of specialized staff in the field of tourism, therefore the possibility of recruiting internal and external staff with a specialty in the field of tourism is suggested; *(Standard III.1, Criterion 4)*
6. NJZHKC does not produce reports at the level of the MP study program in "Management in Tourism, Hospitality and Leisure Activities"; *(Standard IV.4; Criterion 3)*
7. There is a lack of documentation related to work contracts and other documents related to the fulfillment of social and health insurance coverage obligations; *(Standard IV. 1; Criterion 3)*

Recommendations

1. Addition of book titles in foreign languages of the last five years for the MP study program in "Management in Tourism, Hospitality and Leisure Activities";
2. Designing an evaluation sheet with concrete indicators scored according to the importance and weight they should have for this evaluation. This way would help in highlighting the best practices in teaching by academic staff and promoting academic staff with achievements in teaching and scientific research;
3. Strengthening the role of external expertise in quality assessment for the MTMAÇ study program;
4. Drafting a specific financial report for the study program at the Ministry of Education in "Management in Tourism, Hospitality and Leisure Activities";



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|--|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | Përmbushen plotësisht | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |

